



FLET PËR "EPOKËN E RE", JAKUP KRASNIQI | FAQE 4-5

Të gjitha rrethanat na thonë se Nisma shkon e vetme në zgjedhje

-Nisma nuk vendos vija të kuqe për asnjë parti që mund t'i fitojë zgjedhjet

Kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës Social Demokratë, Jakup Krasniqi, ka thënë se bazuar në deklaratimet e partive politike shpërndarja e Kuvendit dhe zgjedhjet e parakohshme nuk kanë alternativë. Sipas tij, ka pak apo hiq gjasa për formimin e një qeverie

teknike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka bërë me dije se të gjitha rrethanat thonë që Nisma do të garojë e vetme në zgjedhjet e parakohshme. Ai ka treguar se në këto zgjedhje presin që qytetarët ta vlerësojnë punën e Nismës në qeverisje

dhe programin e saj zgjedhor socialdemokrat. Sipas Krasniqit, Nisma nuk vendos vija të kuqe për asnjë parti që mund t'i fitojë zgjedhjet. Ai ka shprehur bindjen se ndryshimi në Kosovë vjen me Nismën Socialdemokratë

Java e fundit e shpërndarjes së Kuvendit

Kjo do të jetë java e fundit e legjislaturës VI të Kuvendit të Kosovës nëse subjektet politike parlamentare respektojnë zotimet e tyre se do të votojnë pro shpërndarjes së Kuvendit këtë të enjte, kur do të mbahet edhe seanca e jashtëzakonshme parlamentare për këtë qëllim. Pavarësisht gatishmërisë së subjekteve politike për ta shpërndarë këtë legjislaturë, njohësit e rrethanave politike kanë paralajmëruar se mund të ndodhin edhe befasi. Sipas tyre, në këtë seancë mund të ndodhë të mos bëhen 80 votat e nevojshme për ta shpërndarë Kuvendin | FAQE 3



Haradinaj: Kurrë nuk e lë pa e ndërtuar autostradën e Dukagjinit

FAQE 5



AKTUALE



VESELI: ME MUA KRYEMINISTËR NUK DO KETË VEND PËR UZURPATORË F. 6

SHTYLLAT E VJETRUARA, SHQETËSIMI KRYESOR I BANORËVE TË SENIKUT F. 10

MIMOZA KUSARI VIZITON TOMOR MORINËN NË SHTËPINË E TIJ F. 7

EKONOMI

BANKAT FITOJNË RRETH 90 MILIONË EURO F. 9

REFUGJATËT PO FUTEN MË SHPEJT NË TREGUN GJERMAN TË PUNËS F. 8



KULTURË

DY LIBRAT E LUFTËS QË KULLOJNË DHEMBJE F. 16

Berat ARMAGEDONI

SPORT

JOVANSKI E MINTELI TRIUMFOJNË NË GARËN 'KOSOVA SPRINT TRIATHLON' F. 16

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Protesta në Portland, disa të arrestuar

WASHINGTON, 18 GUSHT- Policia arrestoi të paktën 13 vetë në Portland të shtetit Oregon, vendosi barrierë betoni, mbylli rrugë dhe ura, si edhe konfiskoi një numër të madh armësh në një përpjekje për të parandaluar dhunën mes grupeve të së djathtës së skajshme dhe kundërprotestuesve antifashistë.

Shefja e policisë, Danielle Outlaw e përshkroi të shtunën si një "ditë të gjatë dhe të mundimshme" dhe tha se

shufra metalike, mburoja dhe sende të tjera të forta u konfiskuan nga forcat e policisë, në qendrën e qytetit ku pati shumë njerëz, por jo incidente madhore mes dy grupeve.

Protesta ishte organizuar nga grupi i së djathtës së skajshme "Proud Boys". Përballë tyre ishte grupi i veshur me të zeza i protestuesve antifashistë.

Danielle Outlaw tha se autoritetet arritën t'i mbajnë grupet larg njëri-tjetrit.

Zëdhënësja e policisë tha se në

një periudhë të ditës rreth 1 mijë e 200 veta ishin në rrugë por numri ra në rreth 400 më vonë pasdite.

Kryebashkiaku i Portlandit, Ted Wheeler tha se afro 1 mijë oficerë të policisë së Portlandit ishin në terren të shtunën të ndihmuar nga Policia Shtetërore e Oregonit, forca të tjera policie dhe FBI-ja.

Në një konferencë shtypi në mbrëmje ajo the se ngjarja kishte lidhje me "një lëvizje në rritje të nacionalizmit të bardhë" dhe një ndjesi në frikë në rritje.



Kryebashkiaku tha se Joe Biggs, organizatori i demonstratës së të

djathhtës së skajshme, nuk ishte i mirëpritur në Portland.

Dokumentet sekrete parashikojnë katastrofë nëse ndodh Brexit-i pa marrëveshje

Dokumente sekrete të Qeverisë britanike paralajmërojnë që vendi pritet të përballet me probleme të mëdha nëse largohet nga Bashkimi Evropian pa një marrëveshje tregtare, si ndërprerje të furnizimeve me ilaçe, ushqime e karburant, që mund të zgjasin deri në gjashtë muaj



akademikët dhe ekonomistët, ato janë hedhur poshtë si përhapëse të paniku nga përkrahësit e largimit të Britanisë nga BE-ja. Kryeministri britanik Boris Johnson ka thënë se vendi do të largohet nga Bashkimi Evropian

më 31 tetor pa një marrëveshje edhe nëse nuk do të mundet të rinegociojë marrëveshjen e paraardhëses së tij Theresa May me bllokun.

Megjithatë zyrtarët e kanë paralajmëruar kryeministrin Boris

Johnson se dalja pa marrëveshje nga Brexit, do të vendoste në rrezik bashkëpunimin për ndarjen e informacionit që u nevojitet forcave të zbatimit të ligjit si dhe industrinë e shërbimeve financiare.

Dokumentet e publikuara nga "The Sunday Times" citojnë gjithashtu zyrtarët të paralajmërojnë se deri në 85 për qind e kamionëve nuk do të ishin gati për të kaluar doganat franceze në vendkalimin kritik, Kanalin e Lamanshit në 31 tetor, duke shkaktuar radhë që mund të zgjasin me ditë. Rreth 75 për qind e të gjithë ilaçeve që vijnë në Britania arrijnë përmes këtij vendkalimi, thuhet në dokumente.

Zyrtarët parashikojnë prekje të "elementëve kritikë" të zinxhirit të furnizimit me ushqime "që do të krijonin mungesa në treg e do të rrisnin çmimin, me pasoja te grupet më të prekshme". "The Sunday Times" nuk e ka shpjeguar se si i mori dokumentet edhe qeveria nga ana tjetër nuk i është përgjigjur kërkesave për komente.

LONDËR, 18 GUSHT - Dokumente sekrete të Qeverisë britanike paralajmërojnë paralizim në gjithë vendin në rast se Britania largohet më 31 tetor nga Bashkimi Evropian pa një marrëveshje. Dokumentet u publikuan nga gazeta "The Sunday Times" dhe sipas burimeve qeveritare që nuk pranuan të identifikohen, ato i janë dhënë shtypit nga një ish-ministër.

Britania pritet të përballet me probleme të mëdha nëse largohet nga Bashkimi Evropian pa një marrëveshje tregtare, thuhet në disa dokumente të publikuar nga gazeta "The Sunday Times", ka njoftuar voa.

Në rast të tillë vendi do të përballet me ndërprerje të furnizimeve me ilaçe, ushqime e karburant, që mund të zgjasin deri në gjashtë muaj.

"The Sunday Times" shkruan se dosja ofron një vështrim të rrallë mbi një plan sekret të qeverisë për të shmangur një kolaps katastrofik në infrastrukturën e vendit.

Dokumentet ku detajohet ndikimi negativ në vend në rast të një Brexit-i pa marrëveshje, janë nxjerrë nga një ish-ministër në një përpjekje për të ndikuar negociatat e qeverisë me Bashkimin Evropian, tha një burim qeveritar të dielën.

Sipas të njëjtit burim "dokumenti i përket kohës kur ministrat po bllokoni atë që duhej bërë për t'u përgatitur për largimin dhe fondet nuk ishin në dispozicion", siç tha ai.

Megjithëse skenarët e zyrtarë, që përshkruhen në dokumentet që kanë rrjedhur prej qeverisë, janë diskutuar prej kohësh nga

Basha: Të gjithë opozitarët të hënën në Shkodër!

TIRANË, 18 GUSHT - Sot (e hënë), PS-ja dhe kryeministri Rama e kanë ndarë mendjen të marrin Shkodrën. Pavarësisht se janë zgjedhje moniste, pa dekret, pavarësisht se kandidati i tyre Valdrin Pjetri dha dorëheqjen e përvokueshme nga marrja e postit që e detyruan nga Tirana, pavarësisht se presidenti Meta këmbëngul se nuk ka dekret tjetër për zgjedhjet në Shkodër, përveç dekretit për datën 13 tetor 2019, prapë mazhoranca do t'i mblod-

hë sot (e hënë) këshilltarët e saj që të marrë bashkinë.

Edhe me këto zgjedhje partiake që zhvilloi më 30 qershor PS-ja, përsëri nuk e merr dot Bashkinë e Shkodrës, sepse kryetari i tyre iku me dorëheqje.

Ndaj PD-ja e Shkodrës ka lëshuar kushtrimin që të vijnë opozitarët para vendit ku do të mbledhet "asambleja e tradhtarëve" në qytetin e Shkodrës. Thirrja mbetet për këdo që e ndjen veten opozitar si dhe që nuk pranon marrjen

e kalasë së Shkodrës prej Rilindjes, pa zgjedhje dhe me forcën e policisë.

Edhe Lulzim Basha deklaroi se të hënën në Shkodër do ketë mijëra njerëz për të protestuar kundër mafies së PS-së e cila po turret të marrë edhe qytetin historik të kulturës e të demokracisë.

Mbetet të shikohet sot (e hënë) se sa veta do mblidhen për të kundërshtuar mbledhjen e këshillit bashkiak socialist në Shkodër, ku do të shkarkojnë e



largojnë, pa zgjedhje, Voltana Ademin. Mbetet të shikohet nëse do të

shkojë vetë Lulzim Basha apo do jetë vetëm Voltana Ademi përballë lukunisë së kryeministrit!

Gatishmëria e partive politike për shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës testohet këtë të enjte

Java e fundit e shpërndarjes së Kuvendit



Kjo do të jetë java e fundit e legjislaturës VI të Kuvendit të Kosovës nëse subjektet politike parlamentare respektojnë zotimet e tyre se do të votojnë pro shpërndarjes së Kuvendit këtë të enjte, kur do të mbahet edhe seanca e jashtëzakonshme parlamentare për këtë qëllim. Pavarësisht gatishmërisë së subjekteve politike për ta shpërndarë këtë legjislaturë, njohësit e rrethanave politike kanë paralajmëruar se mund të ndodhin edhe befasi. Sipas tyre, në këtë seancë mund të ndodhë të mos bëhen 80 votat e nevojshme për ta shpërndarë Kuvendin

**EPOKA
ERE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 18 GUSHT- Vullneti i subjekteve politike parlamentare për të shkuar në zgjedhje të reja pritet të testohet këtë javë, kur do të mbahet seanca e jashtëzakonshme plenare për shpërndarjen e Kuvendit.

Këtë të enjte do të shihet përfundimisht nëse partitë politike parlamentare janë pro zgjedhjeve të reja.

Deri më tani zyrtarët e këtyre parive kanë deklaruar se zgjedhjet e reja janë e vetmja alternativë për vendin, madje ato tashmë i kanë deponuar në Kuvend edhe nënshkrimet e deputetëve të tyre për ta shpërndarë legjislaturën VI.

Pavarësisht këtyre qëndrimeve, njohësit e rrethanave politike kanë paralajmëruar se mund të

ndodhë që Kuvendi të mos shpërndahet.

Analisti politik, Vigan Qorrolli, para disa ditësh ka treguar se çka mund të ndodhë nëse partitë politike nuk e shpërndajnë Kuvendin me këtë datë. "Një rrezik që zgjedhje mos të ketë! Në rast se më 22 gusht së paku 80 deputetë nuk votojnë pro shpërndarjes së kësaj legjislaturë. Në rast të votimit negativ (të pasuksesshëm) me 80 vota 'për' - deputetët i japin shkas presidentit të vendit dhe shefave të tyre - të hyjnë në pazar për formimin e një qeverie të re pa zgjedhje", ka shkruar Qorrolli në profilin e tij në "Facebook", duke shtuar se më 22 gusht deputetët nuk kanë punë më të rëndësishme sesa të jenë prezentë në Kuvend. "Kujt i konvenon 'arnimi' dhe kujt i konvenon 'legjitimimi' me zgjedhje të reja, kjo pritet të

shihet sot dy javë. Drita e vetëdijes së re duhet të ndodhë dhe Kuvendi të shpërndahet. Deputetët, asgjë tjetër më të mirë nuk kanë për të bërë, sesa kjo, të enjten e 22 gushtit", ka shkruar ai.

Ndërsa, analisti tjetër politik, Behxhet Shala, ka deklaruar për "Epokën e re" se ndonëse të gjitha partitë politike janë pro zgjedhjeve, në fakt, askush prej tyre nuk i do zgjedhjet. "Jam i sigurt se do të kemi shpërndarje të madhe të votave dhe se dallimi midis të parit dhe të parit (nuk ka parti të dytë) do të jetë e ngushtë. Koalicionet parazgjedhore të subjekteve të mëdha do ta dhunojnë demokracinë, koalicionet e partive të vogla i japin sharmë demokracisë. Askujt nuk do t'i dalin llogaritë ashtu si u thotë kalkulatori i tyre, do të ketë shumë zhgënjime. Por,

diçka jam i sigurt: kushdo që fiton në këto zgjedhje, ndryshimet dhe përparimet do të jenë të papërfillshme. Personalisht do ta përkrah çdo qeveri, çdo parti, çdo koalicion që do të vendosë rend dhe rregull edhe nëse nuk pajtohem me ata", ka thënë Shala. Anëtar i Kryesisë së AAK-së, Muhamet Kelmendi, ka thënë se të enjten do të dihet nëse PDK-ja, Nisma dhe PSD-ja janë për shpërndarjen e Kuvendit. "Shpërndarja e Kuvendit bëhet sipas nenit 82 të Kushtetutës vetëm me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve. Tash varet shumë se më 22 gusht PDK-ja, Nisma dhe PSD-ja a do të votojnë për a kundër shpërndarjes së Kuvendit për të shkuar në zgjedhje! Mendohet se AAK-ja, LDK-ja dhe LV-ja janë për shpërndarje të Kuvendit dhe për zgjedhje të parakohshme. Me shpërndarje i kthehen kompetencat sovranit (popullit)", ka shkruar Kelmendi në profilin e tij në "Facebook". Ndërsa, deputeti i Nismës Socialdemokrate, Zafir Berisha, ka thënë se kjo parti dëshiron që ta kthejë politikën në duart e qytetarëve duke vënë në qendër njeriun dhe nevojën e tij për më shumë liri, të drejta e mundësi të barabarta.

Në profilin e tij në "Facebook", ai ka shkruar se kjo parti dëshiron një parlament që i përfaqëson denjësisht qytetarët e Kosovës, që janë ligjëbërës të përgjegjshëm dhe kontrollues të kujdesshëm të shpenzuesve të parasë publike nga institucionet e shtetit. "Politika e re është pasion, është përkushtim permanent, është shërbim i vullnetshëm dhe i përgjegjshëm. Politika e re është një rrugë e re reformash vizionare që përshpejtojnë ndërtimin e shtetit të së drejtës. Politika e re është dashuri për fëmijët tanë pa dallime etnike, fetare dhe gjinie. Pa asnjë ngurrim a paragjykim, me urtësi e kurajë të njerëzishme, ne do ta kthejmë vullnetin e qytetarëve në një vullnet për mirë qeverisje e solidaritet", ka shkruar Berisha.

Nga caktimi i datës 22 gusht për shpërndarjen e Kuvendit, subjektet politike kanë filluar mobilizimin e strukturave të tyre në terren për zgjedhje të reja.

Në këtë drejtim nuk mungojnë as takimet e liderëve të këtyre partive me grupe të caktuara qytetarësh, duke i prezantuar synimet e tyre për mandatin e ardhshëm.

Flet për "Epokën e re", Jakup Krasniqi

Të gjitha rrethanat na thonë se N

-Nisma nuk vendos vija të kuqe për asnjë parti që mund t'i fitojë zgjedhjet

Kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës Social Demokrate, Jakup Krasniqi, ka thënë se bazuar në deklaratimet e partive politike shpërndarja e Kuvendit dhe zgjedhjet e parakohshme nuk kanë alternativë. Sipas tij, ka pak apo hiq gjasa për formimin e një qeverie teknike. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Krasniqi ka bërë me dije se të gjitha rrethanat thonë që Nisma do të garojë e vetme në zgjedhjet e parakohshme. Ai ka treguar se në këto zgjedhje presin që qytetarët ta vlerësojnë punën e Nismës në qeverisje dhe programin e saj zgjedhor socialdemokrat. Sipas Krasniqit, Nisma nuk vendos vija të kuqe për asnjë parti që mund t'i fitojë zgjedhjet. Ai ka shprehur bindjen se ndryshimi në Kosovë vjen me Nismën Socialdemokrate



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 18 GUSHT - Ish-kryeparlamentari i Kosovës, aktualisht kryetari i Këshillit Kombëtar të Nismës Socialdemokrate, Jakup Krasniqi, ka thënë të dielën se të gjitha rrethanat thonë që Nisma do të garojë e vetme në zgjedhjet e parakohshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se në këto zgjedhje presin që qytetarët ta vlerësojnë punën e Nismës në qeverisje dhe programin e saj zgjedhor socialdemokrat. "Romakët e vjetër e kishin një shprehje e cila thoshte: 'Të gjitha rrugët të çojnë në Romë'. Të gjitha rrethanat na thonë që Nisma në zgjedhje të parakohshme shkon e vetme", është shprehur Krasniqi, duke shtuar se Nisma

nuk vendos vija të kuqe për asnjë parti që mund t'i fitojë zgjedhjet. "Nisma nuk vendos vija të kuqe për asnjë parti që mund t'i fitojë zgjedhjet. Kushtet e vendosura në atë shkrim timin kanë pasur për qëllim mos bërjen e koalicioneve parazgjedhore me asnjë parti tjetër dhe jo vetëm me PDK-në, por shkrimi është parë në një dimension tjetër, që unë nuk e kam menduar. Shkurt, nuk kam qenë e nuk jam për koalicione parazgjedhore të 'meshavinave' politike, por kjo varet shumë nga rezultati zgjedhor pas zgjedhjeve", ka theksuar ai. Sipas Krasniqit, nëse kemi parasysh deklaratimet e partive politike shpërndarja e Kuvendit dhe zgjedhjet e parakohshme nuk kanë alternativë. Ai ka thënë se ka pak apo hiq gjasa për formimin e një qeverie teknike. "Ka vite që zhvillimet

politike në Kosovë kanë në të shumtën dy agenda. Agjenda e bisedimeve me Serbinë dhe ajo e zgjedhjeve apo ndonjë zhvillim tjetër dhe që të gjithë kanë një qëllim: si të mashtrohen zgjedhësit për të fituar sa më shumë vota, por synimi nuk është për të qeverisur mirë. Nëse i kemi parasysh deklaratimet e partive politike, shpërndarja e Kuvendit nuk ka alternativë, ashtu edhe zgjedhjet e parakohshme. Qeveria teknike ka pak apo edhe hiq gjasa", ka deklaruar ai. Sipas Krasniqit, opsioni më i mirë do të ishte sikur mandatet qeverisëse të ishin kushtetuese (katërvjeçare), por kjo nuk ka ndodhur asnjëherë pas shpalljes së pavarësisë. "Sikur zgjedhjet e parakohshme apo të jashtëzakonshme të ishin të lira, të drejta, të ndershme e demokratike, nuk e dëmtojnë vendin, por zgjedhjet të tilla ende nuk kemi parë.

Zgjedhjet e tilla do të ishin në shërbim të integriteteve euroatlantike", ka thënë ai. Në këtë intervistë Krasniqi ka folur edhe për dialogun Kosovë-Serbi, me ç'rast ka thënë se presion për vazhdimin e këtij procesi duhet t'i bëhet Serbisë. "Presioni i vendeve perëndimore duhet të drejtohet mbi Beogradin, pasi aty janë pengesat kryesore për dialogun dhe rezultatet pozitive të dialogut të zhvilluar për disa vite në Bruksel me ndërmjetësimin e BE-së. Pas vendimit të GJND-së, se pavarësia e Kosovës nuk bie ndesh me të Drejtën ndërkombëtare, presioni ndërkombëtar është dashur ta ketë vetëm një adresë: Serbinë!", ka theksuar ai.

"Epoka e re": Z. Krasniqi si e shihni ecurinë e zhvillimeve në skenën politike, do të ketë shpërndarje të Kuvendit të

enjtën dhe zgjedhje të parakohshme apo do të krijohet një qeveri teknike?

Krasniqi: Ka vite që zhvillimet politike në Kosovë kanë në të shumtën dy agenda. Agjenda e bisedimeve me Serbinë dhe ajo e zgjedhjeve apo ndonjë zhvillim tjetër dhe që të gjithë kanë një qëllim: si të mashtrohen zgjedhësit për të fituar sa më shumë vota, por synimi nuk është për të qeverisur mirë. Nëse i kemi parasysh deklaratimet e partive politike, shpërndarja e Kuvendit nuk ka alternativë, ashtu edhe zgjedhjet e parakohshme. Qeveria teknike ka pak apo edhe hiq gjasa.

"Epoka e re": Sipas jush, cili do të ishte opsioni më i mirë për të ardhmen e vendit?

Krasniqi: Opsioni më i mirë do të ishte sikur mandatet qeverisëse të ishin kushtetuese (katërv-

Epoka e re shkronjë e vetme në zgjedhje

malizimin e raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, do të mund të rifillojë ky proces para krijimit të institucioneve të reja nëse do të ketë zgjedhje në vjeshtë?

Krasniqi: Presioni i vendeve perëndimore duhet të drejtohet mbi Beogradin, pasi aty janë pengesat kryesore për dialogun dhe rezultatet pozitive të dialogut të zhvilluar për disa vite në Bruksel me ndërmjetësimin e BE-së. Pas vendimit të GJND-së, se pavarësia e Kosovës nuk bie ndesh me të Drejtën ndërkombëtare, presioni ndërkombëtar është dashur ta ketë vetëm një adresë: Serbinë!

"Epoka e re": Z. Krasniqi të gjitha partitë politike kanë filluar përgatitjet për zgjedhjet e reja, cilat janë pritjet e Nismës nga këto zgjedhje?

Krasniqi: Partitë gjithnjë e kanë të drejtën të përgatiten për zgjedhje. Zgjedhësit duhet të përgatiten që të votojnë për programet politike e zgjedhore, të cilat programe duhet të lexohen e rilexohen me kujdes. Qytetarët duhet t'i ndëshkojnë të gjitha partitë politike që kanë pasur kryeministrin e tyre në qeveritë e pas pavarësisë dhe kanë qeverisur shumë keq. Në këto zgjedhje ne presim që qytetarët ta vlerësojnë punën e Nismës në qeverisje dhe programin e saj zgjedhor socialdemokrat. Qytetarët duhet ta vlerësojnë ofertën e Nismës Socialdemokrate, gjuhën e saj të komunikimit dhe vendosmërinë e saj për të sjellë ndryshimin. Jam i bindur se ndryshimi në Kosovë vjen me Nismën Socialdemokrate. Natyrisht, ndryshimi nuk vije pa vullnetin e lirë të qytetarëve për ndryshim. Në votën e qytetarëve është çelësi i ndryshimit për qeverisje të mirë.

"Epoka e re": Nisma do të garojë e vetme apo në koalicion parazgjedhor?

Krasniqi: Romakët e vjetër e kishin një shprehje e cila thoshte: "Të gjitha rrugët të çojnë në Romë". Të gjitha rrethanat na thonë që Nisma në zgjedhje të parakohshme shkon e vetme.

"Epoka e re": Ju nuk e keni përjashtuar mundësinë e një koalicioni edhe me PDK-në, pse mendoni se do t' i duhet vendit një koalicioni i tillë?

Krasniqi: Nisma nuk vendos vija të kuqe për asnjë parti që mund t'i fitojë zgjedhjet. Kushtet e vendosura në atë shkrim timin kanë pasur për qëllim mos bërjen e koalicioneve parazgjedhor me

asnjë parti tjetër dhe jo vetëm me PDK-në, por shkrimi është parë në një dimension tjetër, që

unë nuk e kam menduar. Shkurt, nuk kam qenë e nuk jam për koalicione parazgjedhore të

"meshavinave" politike, por kjo varet shumë nga rezultati zgjedhor pas zgjedhjeve.

Haradinaj: Kurrë nuk e lë pa e ndërtuar autostradën e Dukagjinit

"Kurrë nuk e lë pa e ndërtuar autostradën e Dukagjinit. Kur pati ardhur Sali Berisha në Kosovë para disa vjetëve, më pati thanë: 'S'kam për të lënë gur pa lëvizur, nëse është nevoja dhe kurrë nuk e lë pa e ndërtuar Rrugën e Kombit! Edhe unë po ju them Dukagjin, kurrë nuk e lë pa e ndërtuar autostradën e Dukagjinit", ka deklaruar kryeministri në largim, njëherësh kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj gjatë një takimi me strukturat e kësaj partie në Junik

EPOKA E RE

Qendresa RAMA

JUNIK, 18 GUSHT - Kryeministri në largim, Ramush Haradinaj, njëherësh kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka vizituar të dielën strukturat e kësaj partie në Junik.

Ai ka thënë se strukturat e AAK-së në këtë komunë janë të mobilizuara për t'i dhënë Kosovës një udhëheqje të guximshme e të vendosur. "Me vizion dhe vlera, që e ka në rend të parë shtetin 100 për qind dhe dinjitetin e tij. Pa kompromise, me efektshmëri të dëshmuar në veprime qeverisëse dhe me objektiv që zhvillimi ekonomik, përballja me korrupsionin e punësimi i të rinjve, të ndodhin vërtet.

Qeveri të dinjitetshme për shtet të dinjitetshëm", ka thënë Haradinaj.

Ai në këtë takim është zotuar se do ta ndërtojë autostradën e Dukagjinit.

Haradinaj u ka thënë dukagjinasve se nuk do të heqë dorë nga ky projekt i rëndësishëm. "Kurrë nuk e lë pa e ndërtuar autostradën e Dukagjinit. Kur pati ardhur Sali Berisha në Kosovë para disa vjetëve, më pati thanë: 'S'kam për të lënë gur pa lëvizur, nëse është nevoja dhe kurrë nuk e lë pa e ndërtuar Rrugën e Kombit! Edhe unë po ju them Dukagjin, kurrë nuk e lë pa e ndërtuar autostradën e Dukagjinit", ka deklaruar Haradinaj.

Lideri i AAK-së ka mbajtur të dielën një takim edhe me

asamblistët e Aleancës në Kuvendin Komunal të Pejës, me të cilët ka diskutuar për zhvillimet politike në vend dhe mobilizimin e kësaj partie për zgjedhjet e parakohshme parlamentare.

Ndërkaq gjatë një takim edhe me Këshillin Drejtues të AAK-së në Lipjan, Haradinaj ka theksuar se nga logjika e sjelljes si protektorat, para dy vjetësh, si kryeministër, është detyruar ta ndërrojë drejtimin e shtetit, duke marrë vendime sovraane në mbrojtje të të drejtës së Kosovës. "Udhëheqja e vendit nga Aleanca është garanci se Kosova do të veprojë në kapacitete të plota 100 për qind shtet dhe për kthimin e vlerave tona subline të nderit, moralit e dinjitetit", ka thënë Haradinaj.

jeçare), por kjo nuk ka ndodhur asnjëherë pas shpalljes së pavarësisë. Opsioni më i mirë do të ishte ndryshimi për qeverisje të mirë. Por, kjo ndodh nëse qytetarët e refuzojnë mashtrimin dhe manipulimin.

"Epoka e re": Mbatja e zgjedhjeve të parakohshme a do ta dëmtojë vendin në procesin e integriteteve euroatlantike dhe proceseve të tjera?

Krasniqi: Sikur zgjedhjet e parakohshme apo të jashtëzakonshme të ishin të lira, të drejta, të ndershme e demokratike, nuk e dëmtojnë vendin, por zgjedhjet të tilla ende nuk kemi parë. Zgjedhjet e tilla do të ishin në shërbim të integriteteve euroatlantike.

"Epoka e re": ShBA-ja dhe Quint-i po bëjnë thirrje për vazhdimin e dialogut për nor-



Veseli: Me mua kryeministër nuk do ketë vend për uzurpatorë

"Shteti i Kosovës do t'i mbrojë investitorët. Nuk ka perspektivë për uzurpatorë, nuk ka perspektivë për njerëzit e korruptuar. Mund të ketë edhe skepticizma në luftën tonë kundër korrupsionit rreth iniciativës sime për çrrënjosjen e korrupsionit, por do të ndodhë i njëjti fat me të korruptuarit sikur me uzurpatorët. Do të luftojmë deri në fund që Kosova të jetë një ambient i volitshëm dhe shumë atraktiv për investitorët e huaj", ka thënë kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli



EPOKA ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 18 GUSHT - Naser Januzi nga Barileva e Prishtinës është një biznesmen i cili pasurinë e vet e ka fituar nga puna në Gjermani dhe pas pavarësisë së Kosovës kishte vendosur që kapitalin e vet ta kthejë në Kosovë. Në vitin 2013 ai kishte privatizuar tri lokale në qendër të Prishtinës, por ato nuk po arrinte t'i zotërojë pasi që nga paslufta ishin uzurpuar. Ai lokalet e tij ka arritur t'i zotërojë vetëm nga viti 2017 falë vendosmërisë së kryetarit të Kuvendit dhe të PDK-së, Kadri Veseli, i cili urdhëroi Policinë e Kosovës që bashkë me AKP-në t'i lirojnë urgjentisht të gjitha pronat e uzurpuara në Kosovë dhe uzurpatorët të përgjigjen para drejtësisë. "Lokalin kam arritur ta privatizoj në vitin 2013 por, për fat të keq, për shkak të parregullsive, tre vjet nuk kam mundur ta shfrytëzoj shkakut i uzurpimeve të paligjshme. Kështu që brenda këtyre tre vjetëve kam shkuar në të gjitha institucionet, kam kërkuar

ndihmë por, për fat të keq, çdoherë kam marrë përgjigje negative. Por, falë iniciativës së z. Kadri Veseli ne sot e gëzojmë lokalin dhe i kemi të gjitha të drejtat. E falënderoj shumë, sepse për momentin çdo gjë është në rregull", ka thënë Januzi.

Lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë me këtë rast se nisma e tij për largimin e gjithë uzurpatorëve nga pronat e uzurpuara do të vazhdojë edhe në të gjitha segmentet e luftës kundër krimit, korrupsionit dhe nepotizmit. "Dikush në vitin 2017 kur e kam marrë iniciativën për largimin e uzurpatorëve nga pronat publike ka menduar se kjo nuk mund të ndodhë kurrë. Ja që sot ka ndodhur. E kemi këtë rast të një ndërmarrësi shumë të suksesshëm në Gjermani i cili gradualisht, me gjithë kapitalin e vet, është duke u kthyer fuqishëm në Kosovë. Shteti i Kosovës do t'i mbrojë investitorët. Nuk ka perspektivë për uzurpatorë, nuk ka perspektivë për njerëzit e korruptuar. Mund të ketë edhe skepticizma në luftën tonë

kundër korrupsionit rreth iniciativës sime për çrrënjosjen e korrupsionit, por do të ndodhë i njëjti fat me të korruptuarit sikur me uzurpatorët. Do të luftojmë deri në fund që Kosova të jetë një ambient i volitshëm dhe shumë atraktiv për investitorët e huaj. Shteti ynë ka nevojë për perspektivë që të rinjtë të jetojnë këtu. Ka nevojë për punësim, për zhvillim ekonomik e atë më së miri e bëjnë ata sikur Naser Januzi i cili ka pasur sukses në Gjermani dhe tani ka ardhur këtu të gjenerojë zhvillim, punësim dhe të mira që pastaj janë për qytetarët tanë", ka thënë Veseli.

Kreu i PDK-së ka folur edhe për rastet korruptive në qeveri dhe

institucionet publike që kanë penguar investitorët e huaj të investojnë në Kosovë. "U ka ardhur fundi. Ka njerëz të korruptuar në Qeverinë e Republikës së Kosovës, në institucione publike, të cilët janë duke menduar se mund t'i vendosin barriera të rinjve dhe perspektivës së Kosovës. Një zyrtar i tillë që i bënë këto, u ndalë perspektivën të rinjve tanë dhe na i largon me dhjetëra të rinj çdo ditë. Por, u ka ardhur fundi. Dhe ky është mesazhi im: Ligji do të funksionojë në Kosovë. Ligji do të jetë i barabartë për të gjithë, qoftë për bartësit e institucioneve, qoftë për ndërmarrësit dhe Kosova të ecë përpara në rrugëtimin e vet euroatlantik,

duke respektuar rendin dhe ligjin. Kjo është e ardhshmeja", ka thënë Veseli.

Ai ka thënë se në qeverinë re që do të udhëhiqet prej tij do të konfiskohen të gjitha pasuritë e atyre që i kanë fituar në kundërshtim me ligjet. "Nuk do t'i gëzojnë. Ne kemi nxjerrë ligjin për konfiskimin e pasurisë së paligjshme dhe të gjithë ata të cilët me haram e kanë krijuar pasurinë e vet, nuk do ta gëzojnë. Do t'u kthehet qytetarëve në pronësi publike. Dhe i inkurajoj ndërmarrësit tanë nga diaspora, edhe të vendeve të tjera, që të investojnë në Kosovë. Kosova do të jetë një vend i investimeve dhe i zhvillimit ekonomik", ka deklaruar Veseli.

Nënkryetari i AAK-së, i bindur edhe për një qeveri Haradinaj

PRISHTINË, 18 GUSHT - Nënkryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Smajl Latifi, ka thënë se asnjëherë nuk kanë qenë më të organizuar se tani për të shkuar në zgjedhje të reja. Ai është shprehur i bindur se pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme që pritet të mbahen sivjet, do të ketë prapë një qeveri Haradinaj. Në një intervistë për "KosovaPress", Smajl Latifi, i cili drejton Komunën e Rahovecit, ka folur edhe për sfidat dhe projektet në këtë komunë. Smajl Latifi thotë se qeveria aktuale ka bashkëpunuar ngushtë me Komunën e Rahovecit, duke pranuar adresimet e komunës dhe duke

dhënë mbështetje maksimale në vazhdimësi. Ai tregon se i kanë dërguar në të gjitha ministritë përkatëse, planet dhe projektet e komunës dhe beson se do ta fitojnë të drejtën të marrin përkrahje në të gjitha ato projekte që janë të rëndësishme për qytetarët e kësaj komune. Latifi thotë se do të punojnë që pas zgjedhjeve të ketë një qeveri e cila vazhdon të jetë e fokusuar në Komunën e Rahovecit.

Në këtë kohë kur Kuvendi i Kosovës pritet të mbajë seancë për shpërndarjen e tij, në mënyrë që t'u hapet rrugë zgjedhjeve të jashtëzakonshme, në AAK thonë të jenë mirë të organizuar dhe të gatshëm për secilën datë që caktohet për



mbajtjen e zgjedhjeve. Nënkryetari i Aleancës thekson se

edhe qytetarët në Rahovec asnjëherë nuk e kanë pasur më

qartë ta vlerësojnë punën e nivelit qendror.

Qeveritarët e dorëhequr mund t'i humbin beneficionet pas mandatit

PRISHTINË, 18 GUSHT- Anëtarët e kabinetit qeveritar në dorëheqje, mund të mos gëzojnë kompensimin financiar pas përfundimit të mandatit. Kjo, pasi në Ligjin për pagat në sektorin publik, i cili pritet të fillojë së zbatuari në muajin nëntor, thuhet se "nëse funksionari publik jep dorëheqje atëherë nuk i takon pagesa kalimtare pas përfundimit të funksionit". Këtë e konfirmon për "Radion Evropa e Lirë", zëvendësministri i Administratës Publike, Hajredin Hyseni. "Ashtu e thotë ligji i ri, mirëpo duhet të ju informojmë se ligji i ri hyn në funksion në muajin nëntor dhe deri atëherë vlen ligji aktual", ka thënë Hyseni.

Ramush Haradinaj dha dorëheqje nga pozita e kryeministrit dhe sipas Kushtetutës, Qeveria në këtë rast bie.

Kuvendi i Kosovës është planifikuar të shpërndahet më 22 gusht. Mirëpo, pasi data e zgjedhjeve të parakohshme do të vendoset pas shpërndarjes së Kuvendit, atëherë nuk mund të thuhet nëse vendi do të ketë Qeveri të re para datës 1 nëntor, kur edhe nis të zbatohet Ligji për pagat në sektorin publik.

Çfarë thotë ligji?

Ligji për pagat e në sektorin publik, përveç funksionarëve që japin dorëheqje, nuk jep të drejtën e pagesës kalimtare edhe për funksionarët që shkarkohen nga funksioni për shkelje ligjore, pastaj nëse pas përfundimit të mandatit, ushtron ndonjë funk-



sion për të cilin paguhet nga buxheti i Republikës së Kosovës, si dhe nëse funksionari me vendim të formës së prerë është shpallur fajtor nga gjykata për një vepër penale të kryer gjatë kohës sa ka bartur funksionin, ose gjatë periudhës së marrjes së përfitimit. Ligji parasheh që kryeministri, pas përfundimit të mandatit, të gëzojë kompensimin kalimtar për pesë vjet në vlerë prej 70 për qind të pagës bazë të fundit, një asistent, një vozitës, një veturë zyrtare si dhe një zyrë të mobiluar.

Zëvendëskryeministrat dhe ministrat, të cilët pas përfundimit të mandatit nuk realizojnë asnjë të hyrë nga buxheti i shtetit, kanë të drejtën e kompensimit kalimtar, për një vit, në vlerë prej 70 për qind të pagës. Ndërkaq zëvendëskryeministrat, pas përfundimit të mandatit, kanë të

drejtën e kompensimit kalimtar për gjashtë muaj, në vlerë prej 70 për qind të pagës.

Për të gëzuar kompensimin material, zëvendëskryeministri, ministrat dhe zëvendëskryeministrat, duhet të kenë ushtruar së paku gjashtë muaj mandatin e rregullt.

Kabineti në largim, ka 21 ministri, pesë zëvendëskryeministrat dhe mbi 80 zëvendëskryeministrat.

Shoqëria civile: Kjo është vazhdimësi e zhvatjes së buxhetit

Mundësia e kompensimit material të funksionarëve publikë, nga ana e shoqërisë civile, vlerësohet në aspekte të ndryshme. Valmir Ismaili nga organizata Demokraci Plus, thotë se në shumicën e vendeve të botës, është praktikë që zyrtarëve pub-

likë t'u njihen disa përfitime pas përfundimit të mandatit.

"Në rrethana normale, kur do të kishim një qeveri të një madhësie aq sa ka nevojë Kosova dhe me numër shumë të kufizuar të ministrave, këto përfitime të përkohshme (dhe vetëm për ata që nuk realizojnë asnjë të hyrë tjetër) nuk do të paraqitnin ndonjë problem as në aspektin buxhetor. Megjithatë, sikurse çdo gjë tjetër në Kosovë, edhe kjo çështje ka marrë konotacion negativ dhe jo pa të drejtë. Krijimi i numrit të madh të ministrave dhe rritja e pafund e numrit të zëvendëskryeministrave të panevojshëm, normalisht që irriton opinionin e gjerë edhe në këtë pike", ka thënë Ismaili.

Sipas tij, pagesa kalimtare duhet të bëhet me shumë kujdes, brenda limiteve dhe kapaciteteve që

ka buxheti i vendit.

Por, ndryshe mendon Besnik Boletini, hulumtues në organizatën joqeveritare "Çohu".

Ai thotë se pagesa kalimtare është një vazhdimësi e zhvatjes së buxhetit dhe taksave të qytetarëve. "Nuk ka asnjë kuptim që një person, për çfarë do pozicioni që mban, të paguhet me muaj të tërë, në këtë rast me 70 për qind të pagës për shkak që ka qenë në një pozicion të caktuar. Tash llogariteni kemi mbi 80 zëvendëskryeministrat pastaj janë edhe ministrat, do të thotë është gjë shumë e pakuptimtare, që këta ia kanë bartur vetvetes. Puna si e tillë edhe në këto pozicione pranohet në mënyrë të vullnetshme. Kjo është vazhdimësi e keqpërdorimit të parasë publike", ka thënë Boletini.

Vendimi për kompensimin e funksionarëve publikë ishte marrë fillimisht në vitin 2005 nga Qeveria e atëherëshme që drejtohej nga Ramush Haradinaj. Aty përfshihej paga pas mandatit në një periudhë 1-vjeçare për ministrat.

Në vitin 2007, Qeveria e atëherëshme që drejtohej nga Agim Çeku solli vendimin e ri që pagat pas mandatit të iu takojnë edhe zëvendëskryeministrave.

Në vitin 2015, Qeveria e drejtuar nga Isa Mustafa, e solli një vendim të ri në të cilin përfshihet paga pas mandatit edhe për drejtorin e Agjencisë Kosovare të Inteligjencës. Por, në këtë vendim, shkurtohet periudha e pagesës kalimtare, për zëvendëskryeministrat, nga një vit sa ishte në gjashtë muaj.

Mimoza Kusari viziton Tomor Morinën në shtëpinë e tij



GJAKOVË, 18 GUSHT (ER)- Kryetarja e Alternativës, Mimosa Kusari-Lila, ka vizituar të dielën ish-ushtarin e UÇK-së, Tomor Morinën, i cili është liruar nga autoritetet e Maqedonisë së Veriut ku po mbahet i arrestuar në bazë të një fletarrestit të Serbisë.

Kusari-Lila ka pohuar se ky rast

duhet t'u shërbejë institucioneve të Kosovës që të jenë më vigjilente për fletarrestet e ish-pjesëtarëve të UÇK-së të cilat Serbia i dërgon në Interpol. "Vizitë e këndshme të Tomor Morinës në banesën e tij në Gjakovë. Përvoja e tij e arrestimit në Maqedoninë e Veriut e ngrit alarmin që institucionet e Kosovës

duhet të jenë më vigjilente për fletarrestet për ish-pjesëtarët e UÇK-së të cilat Serbia i dërgon në Interpol. Një informatë dhe njoftim paraprak për ata që kanë fletarreste, do të parandalonte situatat sikur ato të Tomor Morinës", ka thënë Kusari-Lila pas kësaj vizite.



Një person humbi jetën në një aksident në autostradën 'Ibrahim Rugova'

PRISHTINË, 18 GUSHT (ER)- Një person ka humbur jetën dhe katër të tjerë kanë mbetur të lënduar, nga një aksident trafikuar që ka ndodhur mëngjesin e së dielës në autostradën "Ibrahim Rugova". Si shkak i këtij aksi-

denti një person (femër/viti i lindjes 2002) ka humbur jetën dhe katër persona të tjerë kanë marrë lëndime trupore. Policia është duke hetuar shkaqet dhe rrethanat se si ka ndodhur ky aksident trafikuar.

Bankat fitojnë rreth 90 milionë euro

Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, vlera e fitimit të bankave për vitin 2018 ka arritur në 88 milionë euro. Të hyrat nga interesi për kredi kanë shënuar rritje dhe ishin ndër faktorët kryesorë të rritjes së profitit, krahas të hyrave nga tarifat dhe komisionet



PRISHTINË, 18 GUSHT - Industria bankare vlerësohet të jetë sektori më fitimprurës në Kosovë. Dhjetë bankat komerciale që operojnë në treg, tetë nga to më kapital të huaj, sipas ekspertëve për çështje financiare, kanë gjetur treg të përshatshëm duke mbajtur nivel të lartë të fitimit. Sipas të dhënave të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, vlera e fitimit të bankave për vitin 2018 ka arritur në 88 milionë euro. Të hyrat nga interesi për kredi kanë shënuar rritje dhe ishin ndër faktorët kryesorë të rritjes së profitit, krahas të hyrave nga tarifat dhe komisionet.

Flamur Keqa, ekspert për çështje financiare, në një bisedë për Radion Evropa e Lirë thotë se në mungesë të parave të gatshme, qytetarët dhe bizneset detyrohen të shfrytëzojnë kredi me kamata të larta të interesit, çka automatikisht ndikon në rritjen e

profitit të bankave, kurse vlera e kredive joperformuese në bankat komerciale është më e ulëta në rajon.

Fitimi i madh i bankave private në Kosovë sigurohet edhe nga dallimi i madh në mes normave të interesit dhe depozitave. "Përveç kredive, edhe shërbimet të cilat ua ofrojnë bankat konsumatorëve në Kosovë janë shërbime me çmime jashtëzakonisht të larta dhe të favorshme për bankat. Pra, të gjitha këto kanë determinuar që bankat komerciale të jenë bizneset më fitimprurëse në Kosovë në këta 20 vjet", ka thënë Keqa.

Norma mesatare e interesit për kredi në bankat komerciale është 6.3 për qind, kurse norma e interesit për depozita është 1.2 për qind. Vlera e kredive në këto institucione ka arritur në rreth 3 miliardë euro, ndërsa vlera e depozitave (kursimeve) në rreth

3.5 miliardë euro.

Eksperti tjetër për çështje financiare, Hekuran Murati, thotë se me gjithë faktin se bankat komerciale në Kosovë vitet e fundit kanë ulur normat e interesit për kredi, ato kanë shtrenjtuar çmimin e tarifave për klientët e tyre, duke shtuar se ky veprim ka mbajtur stabil fitimin e tyre.

Reflektimi tjetër që ka ndodhur në fitimin e bankave, sipas tij, është se bankat kanë mbyllur disa sportele dhe kanë vendosur aparate elektronike për kryerjen e shërbimeve. "Shumë banka kanë mbyllur disa degë dhe kjo ka reflektuar në uljen e kostos. Po në të njëjtën kohë ka pasur ulje të kamatave të depozitave që ajo, po

ashtu, ka reflektuar në uljen e normës së interesit. Mirëpo diferencën në mes të kredive dhe depozitave e kanë mbajtur njëjtë. Në të njëjtën kohë, bankat janë bërë më eficiente, kjo ka ndikuar që të rritet profitabiliteti", ka thënë Murati për "Radion Evropa e Lirë".

Disa banka komerciale në Kosovë para disa vjetësh kanë mbyllur disa sportele dhe kanë vendosur aparate elektronike për kryerjen e shërbimeve. Kjo, sipas zyrtarëve të bankave, ka ndodhur për shkak të zvogëlimit të përdorimit të parasë së gatshme dhe që klientët mos të presin në radhë para sporteleve.

Tashmë bankat po kërkojnë nga

klientët që shumë shërbime t'i kryejnë vetë në bankomate si dhe me e-banking.

Kurse Flamur Keqa thotë se me mbylljen e degëve zvogëlohet edhe numri i të punësuarve në këto institucione, që ndikon në ulje të shpenzimeve për bankat. "Reduktimi i numrit të punëtorëve do të ndikojë automatikisht në fitime më të mëdha për bankat. Ndoshta jo në periudhë të shkurtër kohore sepse bankat duhet të investojnë në digitalizimin e sistemeve të tyre, mirëpo në afat të mesëm dhe afat të gjatë me siguri se kjo ndikon në fitime shtesë për bankat", ka thënë Keqa. Zvogëlimi i numrit të punëtorëve dhe njësisive (degëve) të bankave vërehet edhe në raportet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës.

Në raportin e quajtur "Informata mujore të BQK-së", thuhet se në 10 bankat komerciale në qershor të këtij viti janë të punësuar 3 299 punëtorë në 217 njësi, kurse në vitin 2015 kanë qenë të punësuar 3 548 punëtorë në 266 njësi. Në një llogaritje të thjeshtë i bie që për katër vjet janë larguar 249 punëtorë, ndërkaq janë mbyllur 49 degë në rajone të ndryshme të Kosovës.

Refugjatët po futen më shpejt në tregun gjerman të punës

Integrimi në tregun e punës i refugjatëve të ardhur në Gjermani në vitet e fundit po arrihet më shpejt sesa ishte menduar, sipas ekspertëve. Por, pagat e tyre janë relativisht të ulëta

BERLIN, 18 GUSHT - Sipas vlerësimeve të Institutit për Tregun e Punës dhe Studimin e Profesioneve (IAB) në Gjermani refugjatët po integrohen më shpejt në tregun e punës sesa mendohej më parë. "Unë mendoj se në vjeshtë afër 40 për qind e refugjatëve në moshën e punës do të arrijnë të futen në tregun e punës", ka thënë së fundmi drejtuesi i sektorit të migrimit, integritimit dhe studimit të tregut të punës në IAB, Herbert Brucker, për rrjetin redaksional "Netzwerk Deutschland". Ai ka theksuar se me këto ritme mund të jenë të kënaqur. "Po të kujtosh se kushtet fillestare të refugjatëve në vitin 2015 e më pas ishin shumë të vështira, sepse gjermanishtja si gjuhë është shumë më larg arabishtes, se gjuhët e refugjatëve që erdhën nga Ballkani në vitet '90", ka thënë ai.

Me zanat, por pa shkollë profesionale

Bruckeri ka thënë më tej se afërsisht 36 për qind e refugjatëve në moshën 15 deri në 64 vjeç janë të punësuar. "Këta janë rreth 380 000 - 400 000 veta. Shumë prej tyre janë të punësuar si punëtorë për një kohë të kufizuar, edhe pse me rroga relativisht të ulëta", ka thënë ai. Por, përveç kësaj, thotë eksperti Herbert Brucker, ka një numër të madh refugjatësh që punojnë në gastronomi, në fushën e "Security", të pastrimit, në ndërtim dhe në kujdesin shëndetësor ndaj të moshuarve.

Afër 50 për qind e refugjatëve në Gjermani kanë një punë të kualifikuar. "Kjo është një vlerë e lartë, po të mendosh, se vetëm çdo i pesti refugjat para ardhjes ka pasur një shkollë profesionale



apo universitet", është shprehur Brucker.

Ky ekspert shpjegon se në vendet me origjinë ata kanë kryer punë të kualifikuara, edhe pa diplomë

profesionale. "Në vende si Siria nuk ka shkollë profesionale për mekanikët si tek ne. Zanati mësohet në punë", thotë ai. Kurse mjekët apo studiuesit kate-

gorizohen në statistikat e IAB si specialistë. "Në këtë sektor punojnë maksimalisht 6 për qind e refugjatëve", ka deklaruar Bruckeri.

Reagon Maqedonia e Veriut pas vendosjes së masës reciproke nga Kosova

Që nga qershori i këtij viti produktit të Kosovës, rasatit të peshkut, i janë vendosur barrierat tarifore nga ana e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Pasi kanë kaluar dy muaj pa marrë asnjë përgjigje, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë ka vendosur masa reciproke për produktet e Maqedonisë së Veriut që importohen në Kosovë. Ndaj kësaj mase ka reaguar ministri i Bujqësisë në Maqedoninë e Veriut, Trajan Dimovski, i cili ka thënë se ndalimi i importit të rasatit të peshqve nga Kosova nuk paraqet ndalesë të posaçme vetëm për Kosovën



EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

SHKUP, 18 GUSHT - Ministri i Bujqësisë në Maqedoninë e Veriut, Trajan Dimovski, ka thënë se ndalimi i importit të ikrave dhe rasatit të peshqve nga Kosova nuk paraqet ndalesë të posaçme vetëm për Kosovën. Dimovski ka sqaruar se Maqedonia e Veriut ka për qëllim marrjen e lejes për eksport të peshkut të freskët në tregun evropian dhe se për këtë shkak janë rritur standardet në këtë industri.

Ai ka theksuar se pret që së shpejti të arrihet zgjidhje përmes dialogut. "Nuk po implementojnë monitorimin, nuk kanë ndalesë eksplicite, të themi vetëm pse janë prodhime të Republikës së Kosovës, por se masa vlen për të gjitha shtetet e tjera. Nëse dëshmohet se po implementojnë monitorimin, nuk do të ketë asnjë problem", ka thënë Trajan Dimovski, ministër i Bujqësisë. Ky reagim i ministrit maqedonas ka ardhur pas masës reciproke për produktet e Maqedonisë së Veriut nga ana e

Republikës së Kosovës. Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, ka thënë se që nga qershori i këtij viti produktit të Kosovës, rasatit të peshkut, i janë vendosur barrierat tarifore nga ana e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ai ka thënë se për këtë çështje ka qenë në kontakt me autoritetet e këtij shteti dhe ka dërguar ankesa nëpërmes sekretariatit të CEFTA-s, por edhe letër personale ministrit të tyre të Ekonomisë, por deri më tani nuk ka marrë kurrfarë përgjigje. "Dhe tashmë kanë kaluar dy

muaj dhe nuk kemi asnjë përgjigje, prandaj jam i detyruar që në mbrojtje të interesit të Kosovës, biznesit kosovar dhe në mbrojtje të prodhimeve tona, të ndërmar veprime të tjera ligjore në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës. Sot kam marr vendim që të vendos masa reciproke për produktet e Maqedonisë së Veriut që importohen në Kosovë dhe ta ndaloj hyrjen e disa produkteve në mënyrë që ta detyroj shtetin e Maqedonisë së Veriut që të reflektoj dhe të ketë tretman të barabartë për produktet e

Kosovës që hyjnë në atë shtet", ka thënë Shala.

Ai ka theksuar se reciprociteti, partneriteti dhe trajtimi i barabartë i prodhimeve kosovare gjatë eksportit në vendet e rajonit është e vetmja rrugë me të cilën duhet të ecim përpara. "Në rast se ky tretman do të vazhdojë ne do të marrim edhe hapa të tjerë jo vetëm ndaj këtij shteti, por edhe shteteve të tjera. Tashmë asnjë prodhim i Kosovës që eksportohet jashtë nuk do të ketë tretman të pabarabartë", është shprehur ministri Shala.



Pastrohet rruga nga Duhla në drejtim të Suharekës

SUHAREKË, 18 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, i ka vizituar punëtorët të cilët përkujdesen për ambientin e territorit të kësaj komune. Rruga nga Duhla në drejtim të Suharekës është rrugë shumë e qarkullueshme,

andaj kryetari Muharremaj çdoherë ka bërë thirrje për kujdes ndaj kësaj rruge. Ai gjatë vizitës së kësaj rruge u shpreh: "Çdo ditë dhe secilën periudhë kohore ne nuk do të ndalemi për pastrimin e ambientit. Me punë dhe me angazhim së bashku mund ta

realizojmë qëllimin tonë të përbashkët si komuna më e pastër në Kosovë. Punëtorët e 'Eko-Regjionit' janë fokusuar në drejtimin Duhël-Suharekë. Pra, duhet të mbahet ambienti i pastër", ka përfunduar kryetari Muharremaj.



Buxheti i Komunës së Drenasit për vitin 2020 do të jetë 17 milionë euro

DRENAS, 18 GUSHT (ER) - Komuna e Drenasit ka përmbyllur ciklin e dëgjimeve buxhetore në vendbanime për ta diskutuar planifikimin e buxhetit për vitet 2020-2022 pas marrjes së Qarkores Buxhetore 2020/02 të lëshuar nga Ministria e Financave e cila i ka caktuar kufijtë e planifikimit për të gjitha linjat e shpenzimeve të parasë publike.

Ndonëse komuna me kohë dhe sipas ligjit ka bërë njoftimet e takimeve, madje duke i kontaktuar edhe përmes telefonit kryetarët e vendbanimeve e përfaqësuesit e lagjeve, pjesëmarrja e qytetarëve nuk ka qenë e kënaqshme, mirëpo ata pjesëmarrës që kanë qenë të pranishëm, kanë adresuar kërkesat e tyre të cilat janë në interesin e komunitetit ku ata jetojnë.

Javën që lamë pas janë zhvilluar dëgjimet buxhetore në shkollën "Xheladin Gashi-Plaku" në Komoran, ku të pranishëm ishin



kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, drejtori i Infrastrukturës Lokale, Idriz Hysenaj, drejtoresha e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapci, drejtori për Buxhet e Financa, Shyqeri Bublaku, kryetar të fshatrave, qytetarë dhe përfaqësues nga OSBE-ja.

Në bashkësinë e Komoranit janë përfshirë: Komorani I, II, III dhe IV, Kizhnareka, Nekoci, Sankoci,

Fushtica e Ulët dhe e Larta, Korrotica e Ulët dhe e Larta, Zabeli i Ulët dhe i Lartë. Ndërsa është mbajtur dëgjimi buxhetor me banorët e Drenasit I, II dhe III, të fshatit Shtrubullojë, Gllobar, Poklek i Ri dhe i Vjetër, Vasilevë dhe lagja e Feronikelit. Në këto dëgjime kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, ka shpalosur synimet e komunës për buxhetin e vitit 2020 dhe planifikimin për vitet 2021 dhe

2022 dhe ka treguar për projektet që do të zhvillohen në lokalitetet e tyre, ndërsa të gjithë të pranishmit janë pajisur me materialet informuese të projekteve kapitale që janë planifikuar të realizohen gjatë viteve në vazhdim. "Ju para vetes keni edhe një draftlistë të investimeve kapitale si dhe një informatë të planifikimit të buxhetit, por në këto takime, kërkoj nga ana juaj që pasi t'i shihni

propozimet tona, të jepni sugjerimet e juaja, sepse këto takime kanë për qëllim të përgatisim një buxhet sa më të mirë së bashku me ju për t'i realizuar projektet për vitet e ardhshme", ka thënë kryetari Lladrovci, duke shtuar se projektet që shihni para vetes nuk janë të përfshira edhe ato projekte që marrin mbështetje nga niveli qendror dhe donacionet e ndryshme.

Të pranishmit kanë paraqitur sugjerimet dhe propozimet e tyre për projektet që janë në interesin e përgjithshëm të lokalitetit ku ata jetojnë.

Buxheti i Komunës së Drenasit për vitin 2020 do të jetë afër 17 milionë euro, një milion më shumë se i këtij viti, ndërsa afër 5 milionë euro janë të dedikuara për investime kapitale, duke mos përfshirë projektet e nivelit qendror, ndërtimin e rrugës me katër korsi, Polluzhë-Komoran, stadiumin dhe projektet e tjera.

Shtyllat e vjetruara, shqetësimi kryesor i banorëve të Senikut

MALISHEVË, 18 GUSHT (ER) - Në kuadër procesit të hartimit të projektbuxhetit për vitin 2020 po vazhdon mbajtja e dëgjimeve publike në vendbanimet e Komunës së Malishevës. Dëgjimi publik është mbajtur në fshatin Senik, ku banorët e fshatit i kanë prezantuar disa nga nevojat që kanë por, sipas tyre, ajo që më së shumti kanë nevojë, është ndërtimi i shtyllave të energjisë elektrike, pasi ato jenë të vjetruara. Në këtë takim fillimisht drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Valon Mazreku, e ka prezantuar qarkoren buxhetore, me theks të veçantë shtyllën



buxhetore të investimeve kapitale. "Buxheti për investime kapitale është 3 milionë e 850 mijë euro për vitin 2020 dhe ky buxhet do të ndahet për investime në të gjitha vendbanimet. Ne jemi të vetëdijshëm se ky kufiz-

im buxhetor nuk i plotëson nevojat që kemi si komunë, por jemi këtu që bashkërisht t'i paraqesim nevojat dhe t'i nxjerrim prioritetet, në mënyrë që hartimi i listës së projekteve kapitale, të hartohet nga kërkesat që

dalin gjatë këtyre takimeve dhe për këtë qëllim jemi duke i mbajtur këto dëgjime, në të gjitha vendbanimet", ka thënë drejtori Mazreku.

Më pas banorët i kanë paraqitur nevojat dhe shqetësimet e tyre

dhe, sipas banorëve, ata kanë problem me shtyllat e vjetruara të rrjetit të energjisë elektrike dhe disa prej këtyre shtyllave paraqesin rrezik, andaj kërkuar nga komuna që të bëjë presion te kompania përgjegjëse për mirëmbajtjen e këtij rrjeti, që urgjentisht të ndërmarrë masa për zëvendësimin e tyre. Përndryshe, banorët e Senikut thanë se kanë nevojë për ndërtimin e trotuarit në fshat, shtrimin e disa rrugëve, zgjerimin e rrjetit të kanalizimit, disa rrugë në lagjet e fshatit, meremetimin e një rruge të dëmtuar, si dhe shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit në lagjen Jonuzaj.

QKMF-ja në Lipjan bëhet me dy autoambulanca të reja

LIPJAN, 18 GUSHT (ER) - Shërbimi i Emergjencës në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në Lipjan tani është pajisur edhe me dy autoambulanca të reja përmes së cilës do të ofrohen shërbime më të shpejta

shëndetësore në rastet urgjente. Ndërsa pacientët në hemodializë, për transportin e të cilëve kujdeset QKMF-ja, do të kenë një transport më të rehatshëm me autokombi të ri. Drejtoresha e Shëndetësisë, Vlora Limani-

Hajnuni, ka thënë se kryetari Ahmeti do të vazhdojë ta ketë prioritet sektorin e shëndetësisë dhe se do të angazhohet vazhdimisht për përmirësimin e shërbimeve mjekësore për të gjithë qytetarët.



Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (17)

ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



**Përgatiti: Selatin
NOVOSELLA**

Lum na që iu patëm! Ishim e do të jemi besnik ndaj veprës dhe porositve tuaja që na le për së gjalli me vepër! Liria e atdheut mbi të gjitha!

30 korrik 2018,
Fazli Maloku dhe Hasan Maloku,
Stanovc i Epërm

Faleminderit dhe lamtumirë!

30 korrik 2018,
Parim Lepaja

Faleminderit që jetove e vuajte për të gjithë ne, Bacë!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Ngushëllime për Babën e Kombit Shqiptar dhe për kontributdhënësin e pashoq për lirinë kombëtare, Bacën Adem! Faleminderit për kontributin tuaj për ne, që sot jemi të lirë!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Baca Adem ishte frymëzim atdhetar për gjeneratat dhe do të mbetet në memorien kombëtare shqiptare për-gjatë gjithë ekzistencës së këtij populli!

30 korrik 2018,
Sherif Konjufca

Lavdi Babës së kombit, Bacës Adem Demaçi!

30 korrik 2018,
Shefki Azemi, Gjermani

Ike duke i lënë armiqtë me turp!
I le liri atdheut!
Dritë njerëzimit!
I shtrenjti i të gjitha kohërave -
baca Adem Demaçi!

30 korrik 2018,
H. H.

Ishe patriot i vërtetë o baca Adem!
Ke qëndruar 28 vjet në burg dhe asnjëherë nuk u dorëzove! Lavdi të qoftë Mendela i Kosovës por edhe i rajonit dhe i tërë globit! Prehu në paqe humanisti i madh!

30 korrik 2018,
Kadri (mbiemri i palexueshëm)

Baca Adem, të qoftë i lehtë dhe i Kosovës! Allahu të mëshiroftë për tërë çka ke punuar për Kosovë dhe shqiptari!

30 korrik 2018,
Abit Pnishi

Dy kolos të kombit, i pati populli shqiptar në kohën tonë moderne: Adem Demaçin, veprimtarin e pathyeshëm të lirisë dhe të çlirimit të kombit tonë dhe komandantin legjendar, Adem Jasharin, të cilët, popullit tonë do t'i bëjnë dritë si kandili i Naimit, sa të jetë jeta e shqiptarëve!

30 korrik 2018,
Shefqet Riza

Dy patriot më të ndritshëm të Kombit; baca Adem Demaçi dhe Hasan Prishtina! Zoti iu bekoftë të dyve për veprën dhe shpirtin tuaj! Respekt të madh për veprën Tuaj e cila jeton me ne!

30 korrik 2018,
Sabri Nasufi, Norvegji

Shoqata e të Burgosurve Politik - Gjilan
Lavdi Kolosit të të gjitha kohërave, veprimtarit më të devotshëm të shqiptarizms, Bacës Adem Demaçi!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Ai na dhuroi një pjesë të jetës së tij, me të cilën u bë pjesë e jona, u bë

frymëzim i ynë në luftën e gjatë për liri! Baca me qëndresën e tij shkroi pjesën më të ndritshme të historisë sonë! Lavdi, Baca Adem!

30 korrik 2018,
Behxhet Brajshori

Nderimi i jetës, i veprimtarisë dhe qëndresës së Bacës do jetë i përherëshëm edhe për gjithë familjen Demaçi! Ngushëllime të sinqerta për personalitetin unik të Kombit Shqiptar. Respekt për luftëtarin për të drejtat universale të njeriut! Baca Adem një jetë të tërë punoi e luftoi për barazi të njerëzve!

30 korrik 2018,
Bedri Mulaku

Baca, Adem ishte dhe do të mbetet njeriu më i madh i kombit shqiptar!

30 korrik 2018,
Ismet Ajdini

Baca Adem, i veçantë me vepër, me sakrificë, me lavdi! I përjetshëm, unik në mendjen dhe në zemrën e shqiptarëve, për edhe të gjithë njerëzimit! Lavdi, Bacë!

30 korrik 2018,
Mujë Gjonbalaj

Baca Adem, Hero i Kombit Shqiptar. Ngushëllime familjes nga qifti preshevar! Iu qoftë i lehtë dhe i Kosovës, Bacë!

30 korrik 2018,
Sehav Etemi dhe Feime Etemi,
Preshevë

Idealet e Bacës Adem Demaçi janë vizion i tij për gjithë shqiptarët. Ky vizion u realizua edhe kur populli iu përgjigj kushtimit për liri! Edhe pas vdekjes së Bacës Adem, vepra e tij kombëtare do të shndritë me mija vjet për të gjithë shqiptarët!

30 korrik 2018,
Selatin Ahmeti

Ashtu siç ishte, ashtu erdhëm për ngushëllime me respektin më të madh; unë dhe Nezir Gashi, Ramadan Blaku, Xhemajl Gashi me dy djemtë e Nezirit! Neziri ka shoqëruar edhe të tjerë familjar, që kanë ardhur për ngushëllime për Bacën Adem, gjatë tri ditëve.

30 korrik 2018,
Gazmend Gashi

Të kujtoj me respekt meritore, o kolosi i kombit tonë, baca Adem! Vepra juaj është dhe do mbetet frymëzim i jon! Prehu i qetë në tokën arbërore!

30 korrik 2018,
Musa Ibrahim, Llapçevë

Bacë, të qoftë i lehtë dhe i Shqipërisë e Kosovës, që aq shumë i deshe, më shumë se veten!

30 korrik 2018,
Rexhep Doçi

Jeta dhe vepra e Adem Demaçit ishin udhërrëfyes për gjeneratën time! I qoftë i lehtë dhe i Kosovës!

30 korrik 2018,
Sevdail Mustafa

Do të jetë gjithmonë në kujtimet tona, Baca Adem, i guximshëm dhe sakrificues i madh për çështjen kombëtare!

30 korrik 2018,
Valbona Pula

Baca Adem, ishte simbol i rezistencës kombëtare dhe ashtu do të mbetesh gjithmonë! Lavdia jote do jetojë me popullin tonë përherë!

30 korrik 2018,
Xh. Rexha

Gjithmonë do të jesh i pavdekshëm, kryeudhëheqësi i çështjes kombëtare! Të kujtojmë përherë, familja Makolli nga Hertica!

30 korrik 2018,
Behxhet Makolli

Baca Adem, ishte njeriu, që udhën e lirisë e përshkoi me hapin e guximit dhe të vullnetit, kundër padrejtësisë të pushtuesit sllav! I



përjetshëm qoftë kujtimi për Bacën Adem!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Jemi rritur me veprën tënde, Bacë! Vepra jote jemi ne dhe ajo jeton me ne!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Ti i dhe shumë Kosovës e nuk more asgjë prej saj! Zoti të bekoftë, Bacë!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Vepra jote do ketë respektin tonë përherë! Të rrallë janë ata njerëz si të që nuk u luhate para asnjë furtune!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Me respekt për sakrificën e madhe! Zoti të shpërbleftë për kontributin tënd! Pasardhësit do të jenë krenar ashtu si edhe deri më tash për të gjallë! Vepra jote ngjallë respekt kudo, sepse ti ishte kolos i luftës për çështjen kombëtare! Lavdi të qoftë, baca Adem!

30 korrik 2018,
Muhamet Mustafa

Lavdi jetës dhe veprës së heroit të kombit, Adem Demaçit!

30 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Lavdi e përjetshme heroit dhe patriotit kombëtar, Adem Demaçit! Ta përjetësojmë amanetin e tij për bashkim kombëtar!

30 korrik 2018,
Sylë Osmanaj

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)

Nga Smajl Latifit:
Më i fortë se sa guri i këtij atdheu të lashtë;
Burrë i madh i kombit;
Tërë jetën u shkruasi guriri për t'i dhënë dritë lirisë, duke luftuar me terrin e robërisë;
Atdhetar i pashoq dhe i paepur;
Simbol i pathyeshmërisë dhe rezistent përballë vuajtjeve të gjata në burgjet serbojugosllave;
Frymëzues i madh i brezave liridashës dhe brezave pas mesh;
Vepra e këtij Heroi është e përjetshme!
Ky është Adem Demaçi, që e deshëm dhe e duam!
Ky është Bacë Adem Demaçi!

Faksimil i përshtypjes të Smajl Latifit,
kryetar i komunës së Rahovecit

'Andrra në beze' dhe 'Korça sipas një kosovari' si udhëtim në kohë

Zyrafete SHALA

Stili i të shkruarit dhe qasja origjinale për trajtimin e dukurive të ndryshme të mjedisit tonë, me theks të veçantë tek ato kulturore, nuk është e vështirë të dallohet në cilindo shkrim të publicistit Agron Shala. Megjithatë, me dy librat e tij "Andrra në beze" (2018) dhe "Korça sipas një kosovari" (2019), botuar nga "Armagedoni", ai tërheq brenda një bote përplot informacione, një bote që mundëson rrugëtimin nëpër kohë, në shoqëri të kryeveprave të artit, nga e cila lexuesi del ndryshe, i transformuar dhe i pasur me njohuri. Jo rastësisht të dy këta libra janë vlerësuar lart nga njohësit e kulturës dhe letërsisë, por edhe nga lexuesit, të cilët, sado që jetojnë në një epokë që karakterizohet me vërshime botimesh nga të gjitha zhanret, prapëseprapë duhet të jenë të vëmendshëm se me çfarë po e shpenzojnë kohën e tyre. Libri "Andrra në beze" është përmbledhje me njëzet ese nga kultura, në të cilat, siç sugjeron vetë titulli, pikënisje është analiza e filmit, për të vazhduar më tej me gërmimet e autorit nëpër fushat e tjera të veprimtarisë dhe dijës njerëzore, fusha këto që pikëtakohen dhe bisedojnë mes tyre. Përmes gërshetimit të zhan-

reve, Agron Shala arrin të trajtojë një lëndë të gjerë nga fushat e kulturës, filozofisë, psikologjisë, sociologjisë, religjionit e historisë, përmes të cilave i qaset dhe e ndriçon të tanishmen. Ai nxjerr personalitete nga periudha të ndryshme të së kaluarës, të tillë që kanë lanë gjurmë të pashlyeshme, por edhe të tjerë që koha i ka mbuluar me vellon e harresës, i përafrojnë veprat e tyre, i krahason, hedh një dritë të re mbi to, për të nxjerrë pastaj përfundime të vlefshme mbi natyrën e qenies njerëzore dhe mendësisë shqiptare, që sa vjen e bëhet më komplekse.

"Kush vret?" - është pyetja që autori e shtron që në esenë e parë, një pyetje në dukje e thjeshtë, por që kërkon njohje të strukturave të thella të psikikës humane. Por, shqetësimi i autorit nuk përfundon këtu, ai shkon përtej kësaj për të arritur te pyetja tjetër edhe më provokuese: "A mund të vrasë artisti?". Pas elaborimit të tezave që ofrohen si përgjigje të mundshme, ku parakalojnë artistët eminentë dhe kundërshtarë të tyre nga shekuj të ndryshëm të historisë, Shala kthehet në aktualitetin shqiptar. Mirëpo, kur arrin në këtë pikë ai nuk përpiket ta zbulojë potencialin vrasës të artistit shqiptar, përkundrazi, ai sugjeron se në mjedisin tonë mediokrit vishen



me petkun e artistit për ta vlarë artin vetë... dhe ky përfundim është një përshkrim i dhimbshëm i fatit të krijuesit të ne, që duket se ende nuk mund të çlirohet nga mallkimi: "U bëfsh e mos paç ku me u bo!".

Në librin "Andrra në beze" nuk thyhen vetëm kufijtë e zhanreve, thyerja këtu merr përmasa më të mëdha. Në esetë e Agron Shalës thyhen kufijtë e kohëve, disiplinave, ndasitë mes etnive, dallimet në kultura, madje thyhen edhe kufijtë e rrjedhës lineare të mendimit e të narracionit, që na paraqiten ndryshe nga siç jemi mësuar t'i gjejmë në shkrime të tjera. Mënyra e rrëfimit është e tillë që shpeshherë krijon përshypjen e rrjedhës spontane të asociacioneve, por edhe të përfrimit të episodeve që fillimisht dalin të fragmentarizuara, por në fund bashkohen duke krijuar një kolorit impresionues. Me këto veçori "Andrra në beze" shfaqet si një univers unik ku

vlerësimi final i çdo problematike bëhet nga këndvështrimi i artit.

Një mënyrë të tillë rrëfimi gjejmë edhe në librin e dytë "Korça sipas një kosovari", ku Korça na shfaqet me tërë madhësinë e një qyteti të lashtë, që sjell në kohën tonë gjurmët e shekujve të largët. Libri, në kontura të përgjithshme, është i konceptuar si një udhëpërshkrim, që hapet me nisjen, vazhdon me arritjen në destinacion dhe përmbyllet me kthimin. Mirëpo, ky udhëtim, apo kjo rrugë në dukje e shkurtër, del të jetë jo zakonshme dhe hap pas hapi merr kuptimin e një udhëtimi nëpër kohë dhe nëpër epokë, duke marrë trajtën e një gjurmimi brenda shpirtit krijues kolektiv, jehona e të cilit synon të ringjallë një nga tiparet më të veçanta, por edhe më të shpërftuara të natyrës sonë, dashurinë ndërnerëzore dhe dashurinë për të bukurën.

I motivuar nga vargu kuptimplotë "E dimë ku po shkojmë/por nuk e dimë se ku ishim", shpalosjen e tablosë së bukur të Korçës autori e fillon qysh nga vendosja e gurthemeleve të saj, për të vazhduar më tej me informacione të shumta rreth zhvillimit ekonomik, planit urbanistik, arkitekturës, objekteve kulturore e historike, zakoneve, personaliteteve të njohura që

dolën prej aty dhe mendësinë e banorëve të këtij qyteti, që qysh herët tërhuqi vëmendjen e të huajve, për çka u bë i njohur si "Parisi i Vogël në Lindje", epitot ky që nuk i dihet pikënisja. Mirëpo, për autorin pak rëndësi ka se kush e vlerësoi së pari Korçën me këtë epitot, vetë korçarët apo ndonjë nga personalitetet e rëndësishme të kulturës evropiane që u mahnitën me vlerat e saj. Vëmendjen e tij e tërheq fakti paradoksal dhe, natyrisht, i dhimbshëm, që kultura e shtresuar brenda këtij qyteti, nuk arriti ta tërheqë vëmendjen e qeverive postkomuniste dhe, për pasojë, Korça mbeti një qytet ku "varfëria i doli në mbrojtje kulturës". Është kjo një e vërtetë që më së miri ilustron me një fjalë të urtë korçare: "Siç na dinë, qofshim; siç jemi, mos qofshim!"

Duke u ndalur te ngjarjet historike që lanë gjurmët e tyre në këtë qytet, autori arrin t'i shpleksë fjetet që e endin palimpsestin kulturor të Korçës. Gjatë rrugëtimit të tij, autori ndalet dhe i mbledh të gjitha veçoritë e këtij qyteti, i vendos ato si gurët e një ngrëhine dhe krijon një monument madhështor të Korçës. Kushdo që e bën këtë udhëtim, në përfundim të tij do të ndihet ndryshe, sepse do të huazojë shumëçka nga historia, kultura, shpirti dhe ëndrrat e korçarëve...

Dy librat e luftës që kullojnë dhembje

Berat ARMAGEDONI

Për herë të tretë brenda dy muajve Xhevdet Bajraj po i përurojmë në Kosovë librin në gjuhën shqipe dhe në gjuhën spanjolle, "Kur qajnë hardhitë". Ndërkaq, për herë të parë po i përurojmë librin tjetër botuar para dhjetë ditësh, "Ca kokrra rrushi të Rahovecit", botimin e të cilit e ka përkrahur pjesërisht Ministria e Kulturës e Kosovës. Librin "Kur qajnë hardhitë", për shkak të interesimit të madh të lexuesve, shitjes së tij, brenda një muaji e kemi shtypur për herë të dytë po aq sa herën e parë: 500 ekzemplarë. Jehona e botimit të tij është bërë e madhe edhe në Meksiko Siti, vend në të cilin që prej përfundimit të luftës jeton Xhevdet Bajraj, po sidomos kudo ku flitet shqip. Shkrimtari me nam të madh shqiptar dhe botëror, Fatos Kongoli, pas leximit të tij ka thënë: "Nuk njoh sot një poet shqiptar që shkruan poezi më bukur se Xhevdet Bajraj". Kini parasysh: thotë poet shqiptar, jo vetëm poet nga Rahoveci, jo vetëm poet nga Kosova. E thotë këtë një shkrimtar me shije të hollë, që ka shkruar dhjetëra vepra, secilën më të mirë se tjetrën. Ky vlerësim i tij,

sipas bindjes sonë, është me vend sepse poezitë e Bajrajt sot janë kryevepra të poezisë shqipe.

Po ato poezi të mira që i ka libri "Kur qajnë hardhitë", ato vlera letrare i ka edhe libri "Ca kokrra rrushi të Rahovecit", i cili do ta ketë jehonën e tij sepse poezitë e tij kanë brumë, motive, persona dhe personazhe nga Kosova, ata që e kanë Kosovën në mendje dhe në zemër, edhe ata të tjerët që gjithë ditën e zënë emrin e saj ngoje kudo që u shkel këmbë në dhe të huaj, qoftë për të mirë, qoftë për të keq. Dhe kur lexohen këta dy libra të Bajrajt, njeriu vrojton se autori i tyre, kudo që shkon, Kosovën e ka në mendje dhe në zemër, sepse nis e sos shkruan për vlerat e saj njerëzore, për bukuritë e saj natyrore, për njerëzit e saj të mirë, për disa njerëz të ligj dhe për disa të dalldisur krejt, të cilët, meqë nuk kanë trashëguar kulturë familjare e as nuk kanë përfituar nga kultura e mirë e të tjerëve, nëpërkëmbin kulturën, administratën, institucionet e shtetit dhe njerëzit. Këtyre, me poezi, Bajraj u hakërrehet fort, sepse ato dëme që ata ia bëjnë vendit, ky i përjeton si dhembje fizike bërë trupit të tij.

Këta dy libra me poezi të Bajrajt, edhe pse pjesërisht janë shkruar në Meksiko Siti, topikën e kanë në



Kosovë, në të gjithë rajonet e saj, aty ku është përjetuar torturë, ndjekje, plagosje, vrasje, masakër, robëri në kohë luftë; edhe liri, përbuzje, nëpërkëmbje, varfëri në kohë paqe. Patjetër edhe ne që jemi këtu e kemi gjetur dhe do ta gjejmë edhe më tutje vetveten në këta dy libra teksa numërojmë ndodhitë e njëri-tjetrit, sidomos ato në dy dhjetëvjetëshit e fundit. Vështruar në tërësi, këta dy libra me poezi janë miniatura poetike. Përbrenda tyre ka portrete, përshkrime, kujtime, njoftime, rrëfime për karaktere njerëzish, skena komike dhe tragjike, skica dhe skeçe. Duke pasur shije të hollë për këtë lloj të shkrimit dhe për përzgjedhje të këtyre miniaturave, kujdes të posaçëm u kushton edhe titujve të tyre, të cilët janë, pjesa më e madhe e tyre, me vetëm nga një fjalë, kryesisht emra. Ashtu sikurse që ka me bollëk figura libri "Kur qajnë hardhitë",

rush prej figurave stilistike janë edhe poezitë e librit "Ca kokrra rrushi të Rahovecit". Ka në to simbol, personifikim, antitezë, krahasim, metaforë, hiperbolë, litotë, inversion, paradoks, alegori, paralelizëm figurativ. Ka kujtime të mira dhe të këqija. Anktë dhe stres. Krime dhe dëshmi. Foshnja, fëmijë, të rinj, të moshuar, të vjetër. Të gjallë dhe të vdekur. Edhe të vrarë në Abri dhe Padalishtë. Edhe prezantim të krimeve e të dëmeve të mëdha serbe bërë në Kosovë, duke numëruar fëmijët, vajzat, gratë, të moshuarit, pleqtë dhe plakat. Dmth., poezia e Bajrajt ka, përpos letrar, edhe dimension historik, të historisë më të re të Kosovës. Pa dyshim se, duke shkruar poezi edhe në gjuhën spanjolle, të cilat numërojnë disa prej krimeve serbe në Kosovë, autori ndërkombëtarizon çështjen e popullit dhe të kombit tonë. Më tutje, poezia e tij ka homazh për dëshmorë, heronj, viktime dhe ka mirazh për disa udhëheqës zyrysh të të sakatosurve në beteja të luftës, të cilët mezi s'presin t'i korruptojë dikush. Ka dhe ftesë për protestë të qetë e zë të ngritur kundër atyre që pronën e shtetit e përdorin dhe e keqpërdorin më shumë se pronën e vet private. Ka hakërrimë njerëzore për padrejtësi

të ndryshme shoqërore.

Që t'i bie më shkurt, si njëri, "Kur qajnë hardhitë", si tjetri, "Ca kokrra rrushi të Rahovecit", janë libra me poezi dokumentare, janë pjellë e luftës së Kosovës dhe lirisë së nëpërkëmbur të saj. Këso përmbledhje me ngjarje të luftës e të pasluftës, shkruar në këto përmasa shoqërore, kulturore, arsimore, shkencore, për dëmet njerëzore dhe ekonomike që i janë bërë vendit tonë nga serbët, na kanë munguar gjatë dhe shumë ashtu siç u kanë munguar për disa vjet boshnjakëve librat e Izet Sarajliqit dhe të Marko Veshoviqit, të cilët kasaphanën serbe dhe dhembjen e madhe boshnjake e kanë dërguar në çdo vend të botës. Veprat e Xhevdetit kanë përafri të madhe me të tyre.

Ky autor me këto dy vepra letrare është përkujdesur për të kaluarën tonë të përgjakshme më mirë se një historian. Prandaj, në vendlindje e vet dhe në popullin, shtetin dhe kombin tonë, meriton nderim të madh.

Pastë shëndet të mirë për të ngrënë edhe ndonjë kokërr rrush dhe për të shkruar sërish ca kokrra rrushi jo vetëm nga Rahoveci!

(Shkruar posaçërisht për përuarimin e dy librave të Xhevdet Bajrajt, në Rahovec)

Këngëtari i njohur lëndohet në skenë, shkon në spital



Këngëtari i muzikës country, Drake White, është shtrirë në spital të premtën në mbrëmje pasi ka qenë duke u rrëzuar në skenë gjatë koncertit. Një burim për "People" ka thënë se ai ka qëndruar 15 minuta në skenën e amfiteatrit "Elmwood Park" në Virginia, pasi

ka ndodhur incidenti. Pasi ngeci në skenë ai u dërgua menjëherë në spitalin më të afërt për shërim. Këngëtari me anë të një postimi në "Twitter" u ka kërkuar falje adhuruesve për ndërprerjen e koncertit dhe i ka falënderuar ata që u lutën për të dhe që e mbështetën.

Jamie dhe Katie u ndanë? Aktori shihet me një grua tjetër



Njerëzit kanë filluar të spekulojnë rreth statusit të lidhjes së Jamie Fox dhe Katie Holmes pasi ai u pa me një grua tjetër. Aktori 51-vjeçar u fotografua duke u mbajtur për duar me një grua të panjohur teksa po dilnin nga një

klub nate në Hollivud. Jamie po e mbante për dore gruan misterioze gjatë drejtimit të saj për te vetura e vet "Lamborgini SUV". Hera e fundit që Katie dhe Jamie u panë së bashku ishte kur morën pjesë në Met Gala si çift në muajin maj.



Normani publikon këngë të re

Normani e ka publikuar këngën e re "Motivation" dhe videoklipi i ka bërë të gjithë të flasin. Këngëtarja 23-vjeçare e ish-grupit Fifth Harmony i ka nderuar disa prej këngëve tona

të preferuara të viteve '90-ta me këtë video të re muzikore. "E ka regjistruar këtë këngë kohë më parë", i tha Normani revistës "Rolling Stone" në fillim të këtij muaji.

Meghan vendos rregullin e ri në familjen mbretërore



Dukesha e Sussex, Meghan Markle, si aktiviste për të drejtat e kafshëve, i ka ndaluar familjes mbretërore që të shkojë për gjueti shpendësh. Kjo ishte një traditë që ndiqej çdo vit nga pjesëtarët e pallatit "Kensington", mirëpo s'do të përsëritet më këtë vit. Pas

vendimit të Meghanit, e gjithë familja mbretërore ka hequr dorë nga gjuetia, duke mbështetur unanimitisht Meghanin për t'i mbrojtur kafshët e shpendët. Kjo nuk është hera e parë që dukesh del kundër rregullave të pallatit mbretëror dhe vendos rregulla të tjera.

E rrallë

Shkatërroan skulpturën në hotel, policia në kërkim të turistëve

Dy vajza turiste po kërkohen nga autoritetet në Hawaii pasi shkatërroan skulpturën prej rëre në hollin e hotelit. Incidenti ndodhi më 12 gusht në Honolulu rreth orës 23:16. Videoja e regjistruar nga kamerat e hotelit tregon një vajzë që godet me jastëk skulpturën. Pas kësaj,



ajo kalon mbrojtëset e xhamit dhe prek skulpturën. Ndërkohë që shkatërroon artin, shoqja e saj filmon "spektaklin" në telefon.

FOTO E DITES



Një burrë në Frankfurt të Gjermanisë shihet duke shkuar në punë me biçikletë para lindjes së diellit. /AP/

E jashtëzakonshme

Banja publike të pajisura me teknologji kundër seksit

Një qytezë bregdetare në Britaninë e Madhe ka bërë të mundur që banjat publike të mos jenë dosido, por të kenë masa kundër vandalëve, atyre që mund t'i përdorin për të fjetur ose për seks. Dyshemetë e banjave janë të ndjeshme ndaj peshës dhe mundësojnë që të futet vetëm



nga një përdorues për çdo herë. Nëse ka lëvizje të vullshme, si në raste seksi, një spërkatës do t'i lagë përdoruesit automatikisht dhe do të ndizet një alarm me zhurmë.

BARSOLETA E DITËS



Në një restorant në Shqipëri: Kamerieri: Zotëri, ju pëlqeu ushqimi? - Po, shumë. Do të vijmë përsëri vitin tjetër.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30 "Spider-Man Far From Home" 3D,

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 09 min
Rolet: Tom Holland, Samuel L. Jackson, Zendaya, Cobie Smulders, Jon Favreau, JB Smoove, Jacob Batalon, Martin Starr, Marisa Tomei, Jake Gyllenhaal

Regjia: Jon Watts



Çdo ditë në ora 17:30

"THE LION KING" 3D

Aventurë/Dramë; 1 orë 58 min

Rolet: Donald Glover, Seth Rogen, Chiwetel Ejiofor, Beyoncé Knowles-Carter, James Earl Jones, Alfre Woodard, John Oliver

Regjia: Jon Favreau



Në ora 19:30 dhe 22:00

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.

Regjia: David Leitch




Nga dt. 08.08.2019

"THE ANGRY BIRDS MOVIE 2"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj

Regjia: Thurop Van Orman



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: **Kino ABC**.



DASHI

Sot edhe një herë do të jeni ju që do të


nxirrni nga situata një person të afërt. Megjithatë të papërgatitur, do të arrini t'ia dilni në një situatë të caktuar.



DEMI

Do të ngriheni me humor të keq sot

dhe që në orët e para të ditës ata që kanë punë me ju do ta kuptojnë që diçka nuk shkon.



BINJAKËT

Keni dëshirë të merrni pjesë në

shumë aktivitete dhe iniciativa sot, por edhe një ditë e plotë nuk ju mjafton.



GAFORRJA

Sot jeni mjaft ambicioz dhe do të

tregoni që dini të luftoni për atë çka mendoni të drejtë si dhe të merrni atë që ju takon me meritë.



LUANI

Jeni shumë protektiv karshi

personave të dashur sot. Mbase duhet të kuptoni që gabimet në jetë mësojnë shumë më tepër se teoritë.



VI RGJËR ESHA

Sot nuk do të toleroni më

neglizhenca të tjera lidhur me një projekt tuajin. Jeni munduar t'i mirëkuptoni të tjerët deri më sot, por e kanë marrë si dobësi.



PESHORJA

Sot me durim do të arrini të shmangni

edhe ato situata të pakëndshme që mund t'ju shënojnë ditën. Ndjeni një frymë pesimizmi në ambientin e punës.



AKREPI

Edhe pse ju duket se i keni financat e

sigurta për ca kohë nuk duhet të qëndroni në vendnumëro. Keni mundësi të ecni përpara në karrierë.



SHIGJETARI

Sot keni humbur në

mendime dhe nuk shihni se çfarë bëhet rreth jush. Dikush mund të përfitojë nga mosvëmendje juaj.



BRICJAPI

Pak pushim nga rutina do

t'ju ndihmojë të nisni përsëri me këmbën e mbarë. Do të arratiseni në një vend që ju pëlqen shumë.



UJORI

Dihet që sa më lart

kërkon të ngjitesh aq më të mëdha bëhen pengesat. Kjo vlen edhe për rastin tuaj, por nuk do t'ju trembë për të guxuar më shumë.



PESHQIT

Sot do të ndiheni mjaft

krenar për një gjest tuajin dhe nuk do të bëni modestët tek ata persona që do t'ju përgëzojnë pa asnjë rezervë.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

Superliga nis me befasi

Edicioni 2019/2020 në Superligën e Kosovës në futboll nisi me befasi. Spikasin fitorja e Ferizajt ndaj Dritës dhe Trepçës '89 ndaj Gjilanit, por edhe dështimi i Prishtinës ndaj Flamurtarit. Kampionët e Feronikelit e filluan fuqishëm, duke e deklasuar Drenicës (4-1)



EPOKA ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 GUSHT - IPKO Superliga e Kosovës në futboll ka nisur me befasi të shumta qysh në javën e parë. Barazimi i Prishtinës ndaj Flamurtarit, humbja e Dritës nga Ferizaj dhe fitorja e thellë e Trepçës '89 ndaj Gjilanit nuk ishin shumë të pritshme. '89-shi me lehtë që është pritur e mposhti skuadrën e Gjilanit, e cila në afatin kalimtar të verës bëri shumë përforsime dhe nga opinionistët konsiderohej favorit për titull. Adrian Muja shënoi dy gola në pjesën e parë, kurse nga një tjetër e shtuan nga penalltia Arb Manaj dhe Leart Emini për fitoren e Trepçës, derisa nga penalltia e shënoi edhe Gjilani, kurse autor Bushiç. Fitore mjaftë befasuese ka shënuar Ferizaj të dielën në udhëtim ndaj Dritës (0-1). Pjesa e parë u mbyll pa gola, ani pse rastet nuk munguan për të dyja klubet. Pesë minuta para fundit të ndeshjes, vendasit mbetën me një lojtarë më pak për faktin se Gilberto u ndëshkua me karton të kuq. Ndërsa edhe me keq për ish-kampionët e Kosovës erdhi në minuat shtesë kur Filonit Shaqiri shënoi golin e fitores. Duhet cekur se Shaqiri në kampionatin e fundit ishte pjesë e Dritës. Ndërsa skuadra e Dukagjinit të

Klinës debutoi në Superligë me barazim, sepse luajti pa gola me Ballkanin e Suharekës. Feronikeli e ka nisur garën për ta mbrojtur titullin e kampionit me fitore, pasi e ka mposhtur Drenicën me rezultat bindës 4-1. Shënuesi më i mirë i edicionit të kaluar tregoi klasin e tij duke shënuar dy gola. Një gol nga penalltia e shtoi Jean Carioca, kurse në listën e shënuesve u shtua edhe Jean Carioca, derisa golin e nderit për skuadrën nga Skenderaj e realizoi Diar Prokshi. Me fitore edicionin e ri e ka nisur edhe skuadra e Llapi, e cila e mposhti Vushtrrinë. Ishin mysafirët që kaluan të parët në epërsi me golin e Jasmin Raboshtës, por vendësit nuk u dorëzuan në asnjë çastë dhe e përmbysën rezultatin me dy golat e shënuara nga Enis Zabërxha dhe nga një gol e shënuar Arbnor Ramadani dhe Labinot Osmani. Ndryshe nga Feronikeli dhe Llapi, Prishtina e nisi në mënyrë jo të mirë kampionatin duke barazuar ndaj rivalit nga kryeqyteti, Flamurtarit (1-1). Pas dy minutave lojë, Agron Bruqi e kaloi në epërsi skuadrën kuqezi dhe në këtë mënyrë e shënoi golin e parë të kampionatit 2019/2020. Prishtina u rikthye në lojë në minutën e 15-të, kur Ahmet Januzi barazoi shifrat në 1-1. Deri në fund të ndeshjes shanset nga të dyja

klubet nuk munguan, por rezultati mbeti i pandryshuar dhe ndeshja përfundoi 1-1.

IPKO SUPERLIGA

| | |
|-------------------------------|------------|
| Drita - Ferizaj | 0-1 |
| Trepça'89 - Gjilani | 4-1 |
| Dukagjini - Ballkani | 0-0 |
| Feronikeli - Drenica | 4-1 |
| Flamurtari - Prishtina | 1-1 |
| Llapi - Vushtrria | 4-1 |

TABELA

| | |
|----------------------|---------------|
| 1. Feronikeli | 3 pikë |
| 2. Llapi | 3 |
| 3. Trepça '89 | 3 |
| 4. Ferizaj | 3 |
| 5. Flamurtari | 1 |
| 6. Prishtina | 1 |
| 7. Dukagjini | 1 |
| 8. Ballkani | 1 |
| 9. Drita | 0 |
| 10. Drenica | 0 |
| 11. Vushtrria | 0 |
| 12. Gjilan | 0 |

Në xhiron e dytë takohen: Ferizaj-Gjilani, Vushtrria-Trepça '89, Drenica-Llapi, Ballkani-Feronikeli, Prishtina-Dukagjini, Drita-Flamurtari.

SHKURT

Howard, lojtar i ri i KB Rahoveci

KB Rahoveci është përforsuar edhe me një basketbollist të huaj. "Vreshtarët" kanë konfirmuar se është Javis Howard, basketbollisti i pestë i huaj që do ta veshë fanellën "bardhekaltër". "Howard, basketbollisti i 5-të i huaj te KB Rahoveci, mirë se vjen", thuhet në konfirmimin e KB Rahoveci. Kjo skuadër pritet të përforsohet edhe me lojtarë të tjerë.

Rashica e nisi me asistim dhe humbje

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Milot Rashica, ishte titullar në ndeshjen e parë të Werder Bremenit në Bundesliga ndaj Fortuna Dusseldorfit (1-3). Rashica asistoi në golin vetëm që shënoi Bremenin nëpërmjet Johannes Eggestein, kurse në minutën e 65-të u zëvendësua me Nicolas Fullkrugun.

Roma seriozisht e mendon transferimin e Hysajt

Janë duke vazhduar bisedimet në mes të Romës dhe Napolit për transferimin e mbrojtësit shqiptar Elseid Hysaj në kryeqytetin italian. "La Gazzetta dello Sport" raporton se skuadra e Romës e dëshiron Hysajn në këtë afat kalimtar, kurse për transferimin e tij duhet të paguajë rreth 20 milionë euro. Emri i Hysajt ditë më parë është lidhur edhe me Atletico Madridin, Tottenhamin dhe Juventusin.

Suarezi mungon 1 muaj

Kampionia e La ligës, Barcelona e humbi ndeshjen e parë të këtij edicioni nga Bilbao, kurse në këtë ndeshje është lënduar edhe sulmuesi Luis Suarez. Sipas medieve spanjolle, lëndimi që pësoi në ndeshjen ndaj Bibaos do ta lërë uruguianin rreth katër javë jashtë fushave. Suarez do t'i nënshtrohet testeve mjekësore për të kuptuar shkallën e lëndimit.

Levante nuk llogaritet në Sadikun

Karriera e Armando Sadikut është në rrezik, pasi mund të mos marrë asnjë minutë në 6 muajt e parë te Levante. Elbasanasit nuk ka gjetur ekip të ri dhe duket se do të mbetet në Spanjë, aty ku trajneri Paco Lopez nuk e do në skuadër. Numri një i stolit ia ka bërë të ditur, por sërish futbollisti i kombëtares nuk ka gjetur skuadër të re. Ai nuk është përfshirë në listën e futbollistëve të grumbulluar nga tekniku për ndeshjen e parë të kampionatit.

Kosova përfundoi parakualifikimet në 'Eurobasket 2021'

PRISHTINË, 18 GUSHT - Britania e Madhe e ka mposhtur Kosovën 101:79 (24:12, 30:20, 24:23, 23:24) në Mançester për t'u kualifikuar në rrethin e ardhshëm. Kjo ishte ndeshja e fundit e Kosovës në parakualifikimet e "Eurobasket 2021". Në takimin e zhvilluar në Mançester,

Kosova luajti mirë në pjesën e dytë, megjithatë ishte e pamjaftueshme për të shënuar fitore, derisa për kualifikim duhej një fitore me më shumë se tetë pikë dallim, kurse Britania duhej të humbiste edhe në takimin e fundit me Luksemburgun. Drilon Hajrizi ishte

shënuesi më i mirë te Kosova me 22 pikë, kurse Dardan Berisha kishte 19 pikë e 11 asistime, derisa me 13 pikë ndihmoi Divine Myles. Britania u kualifikua në rrethin e ardhshëm, ku do të jetë në grup me Gjermaninë, Francën dhe Malin e Zi.



Jovanovski e Minteli triumfojnë në garën 'Kosova Sprint Triathlon'

PRISHTINË, 18 GUSHT - Federata e Triathlonit të Kosovës ka mbajtur për herë të parë garën "Kosova Sprint Triathlon", e cila është organizuar në bashkëpunim me Komunitetin e Podujevës në vendin Orllan, tek liqeni i Batllavës. Në këtë garë kanë marrë pjesë rreth 50 garues si brenda, ashtu edhe nga jashtë shtetit të Kosovës. Garuesit kishin për detyrë të notonin në gjatësi prej 750 metra, pas notit ishte gara me biçikleta që garuesit duhet të garonin për 20 kilometra, ndërsa në fund të vraponin në shtegun me gjatësi prej 5 kilometrash. I pranishëm në këtë garë ishte edhe kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani. Ai ka thënë se kjo federatë është e re dhe ka nevojë të madhe për përkrahje dhe Komiteti Olimpik do të jetë vazhdimisht afër tyre. "Muaj më parë është themeluar Federata e Treathlonit dhe i është bashkuar listës së federatave olimpikë dhe tani kem të bëjmë me një sport Olimpik një sport shumë atraktiv që kombinon tri sporte olimpikë dhe sot këta po e organizojnë Treathlonin në sprint të Kosovës dhe ishte mjaft inkurajuese numri i madh i sportistëve që ishin diku afër 50 sportistë. Është një fillim i mbarë. Jam i bindur që vitin e ardhshëm do ta kalojë numrin e 100 pjesëmarrësve dhe këta do të përgatiten me kohë. Po shihet se është një organizim i mirë me të gjithë anëtarët e kësaj federate, por edhe më shumë vullnetarë, kujdestarë", ka thënë Hasani. Ndërsa, kryetari i kësaj federate, Vedat Tërmerkollu u shpreh se kjo është hera e parë që kjo federatë organizon zyrtarisht një garë të tillë. Ai gjithashtu tha



se ka qenë tejet i lumtur me numrin e pjesëmarrësve në këtë garë. "Organizimi nuk ka qenë edhe i lehtë, mirëpo me mobilizimin e të gjithëve ia kemi arritur t'ia dalim. Me ndihmën e Ministrisë, Komitetit Olimpik, dhe federatave ndihmëse si federata e atletikës, notit dhe çiklizmit, ia kemi arritur të organizohemi mjaft mirë. Duke e llogaritur që është hera e parë në Kosovës, jemi shumë të kënaqur me pjesëmarrjen e garuesve. Kemi garues që kanë ardhur nga jashtë, kemi garues nga misionet e ndryshme që janë në Kosovë. Jam shumë i kënaqur me pjesëmarrjen", ka deklaruar Tërmerkollu. Fitues i këtij Triathloni në kategorinë e meshkujve u shpall atleti nga Struga, Dimitar Jovanovski, vendin e dytë e zuri atleti kosovar Albion Ymeri, ndërsa, i treti përfundoi Nikola Kutanoki. Dimitar Jovanovski pas garës u shpreh tejet i lumtur. Ai ndër tjerash tha se ky organizim dukej sikur nuk ishte hera e parë, duke e pasur parasysh edhe numrin e pjesëmarrësve. "Jam nga Struga dhe vi nga klubi i Treathlonit '3 disiplina' gjithashtu nga Struga. Gara këtu ishte shumë e mirë. Duhet ta theksoj se noti ishte shumë i mirë, uji ishte pak i ftohtë, gjithashtu edhe në çiklizëm dhe vrapim, kalova mjaft mirë. Në përgjithësi

gjithçka ishte në rregull dhe e shijova garën", ka shtuar ai. Ndërsa, atleti kosovar Albion Ymeri i cili arriti i dyti në finish, pohoi se ishte disiplina e notit aty ku hasi në vështirësi dhe ku humbi shumë minuta gjatë garës. "Kushtet atmosferike kanë qenë shumë të mira, nuk ka qenë garë e vështirë, ka qenë një garë tejet interesante, duke e parë edhe tri disiplinat tejet interesante, njëra pas tjetrës, kështu që jam ndjerë tepër mirë. Noti mundem të them pak më e vështirë, pasi që nuk jam profesionist në not. Atë e kam pasur synim vetëm me përfunduar, ndërsa në biçikletë dhe vrapim kam pasur mundësi me arrit më shumë pikë", u shpreh Ymeri. Në kategorinë e femrave fituese doli Jozefina Mintel, e dyta u rendit Rita Zeqiri, ndërsa, e treta përfundoi Kaltrina Selmanaj. Fituesja Jozefina Mintel, pas garës u shpreh e lumtur me fitoren duke theksuar se është hera e parë që merr pjesë në një treathlon. "Gara ka qenë shumë e mirë. Organizimi ka qenë shumë i mirë. Është hera e dytë që jam në Kosovë dhe është një ndjenjë shumë e mirë të jesh këtu. Ka qenë me të vërtetë vështirë për mua. Nuk kam marrë pjesë asnjëherë në Treathlon ndonjëherë, ishte hera e parë dhe ka qenë shumë vështirë", ka përfunduar ajo. Gjatë këtij treathloni u mbajt edhe gara kampionale ku kishin drejt të garonin garuesit nga Kosova të cilët janë të regjistruara me klubet e tyre në Federatën e Treathlonit të Kosovës. Në këtë kategori tek meshkujt i pari doli atleti, Albion Ymeri, ndërsa tek femrat e para përfundoi Rita Zeqiri.

Mançini: Juve, skuadra më e mirë në Itali, Milani do të jetë surprizë

MILANO, 18 GUSHT - Roberto Mançini mendon se Juventusit është larg skuadra më e mirë në Serinë A, kurse Interit i duhet kohë për ta kapur Napolin. Ndërsa Milani mund të jetë ekipi surprizë. Mançini të dielën për "Gazzetta dello Sport" bëri parashikimin e tij për edicionin e ri në Serinë A. "Është shumë herët për të thënë kush do ta fitojë 'Scudetto', por Juventusit është skuadra më e mirë. Mos të harrojmë se ata kanë fituar titullin në tetë vjetet e fundit dhe gjithashtu janë forcuar: Interi gjithashtu është forcuar, por Juventusit nuk është ndalur", ka thënë fillimisht Mançini. "Unë e shoh Napolin të rrezikshëm. Ata



kanë lojtarë që kanë luajtur tashmë prej vitesh së bashku, ndërsa Interi tashmë ka ndryshuar 4-5 lojtarë dhe ka humbur disa lojtarë të rëndësishëm si Icardi dhe Perisic. Ata kanë nevojë për pak kohë para se të vlerësohen, por sigurisht se po përmirësohen. Tani për tani jam duke shkuar me Juven,

Napolin dhe Interin në atë rend", ka shtuar Mançini. "Fonseca është një trajner i mirë: ai ka filozofinë e futbollit portugez dhe një ide të shkëlqyer se si ta luajë ndeshjen. Është e vërtetë që Shakhtar pothuajse gjithmonë fiton në Ukrainë, por ekipet e tij gjithmonë kanë luajtur futboll të mirë. FFP është një problem për Milanin, i cili detyron të blini pak në tregun e transferimeve, edhe nëse duhet të hiqni dorë nga Liga e Evropës. Megjithatë, nëse ndryshoni trajnerin, të keni më shumë kohë për të stërvitur mund të jetë një avantazh pasi mund të fitoni më mirë mendimet tuaja: Milani mund të jetë befasia e sezonit", ka deklaruar Mançini.

SHKURT

Muslija shënon gol të bukur për Hannoverin

Mesfushori kosovar Florent Muslija ka shënuar një gol të bukur në ndeshjen midis Hannover 96 dhe Wehen Wiedbaden. Ai në minutën e 56 arriti ta ngrehë epërsinë në 3-0 për klubin e Hannoverit. Ndërsa dy golat e parë i ka realizuar bashkëlojtari i tij Marvin Ducksch.

Modriqi: Veprimi ndaj lojtarit kundërshtar, i paqëllimshëm

Real Madridi zhvilloi ndeshjen e parë për këtë sezon në La Liga, kundër Celta Vigos, të cilën e fituan me rezultatin 1-3. Madrilenëve iu duhej të luanin me 10 lojtarë për më shumë se 35 minuta për shkak të kartonit të kuq të marrë nga Luka Modriq. "U ndëshkova për një veprim aksidental. Unë nuk do të bëja kurrë me qëllim një veprim të tillë kundër një lojtari tjetër. Krejtësisht e pavullnetshme", ka thënë Modriqi.

Jesusi kritikon VAR-in

Manchester City dështoi ta sigurojë fitoren e dytë në Premierë Ligë teksa nuk shkoi më shumë se barazimi 2-2 në ndeshjen kundër Tottenhamit. Skuadra e Guardiola është dominuese gjatë gjithë ndeshjes, por "Spurs"-at shfrytëzuan shumë mirë dy rastet e vetme që kishin dhe arritën të marrin një barazim të vlefshëm kundër një kundërshtari që është pretendenti kryesor për titull. Vendësit iu afruan shumë fitores, teksa në minutat e fundit Gabriel Jesus arriti të gjejë rrugën e rrjetës, por ishte VAR-i ai që e anuloi atë. Pikërisht ky episod e irritoi shumë sulmuesin brazilian, i cili nuk mund ta kontrollonte veten në fund të ndeshjes. Pas fishkëllimës përfundimtare të arbitrit, Jesus është kapur nga kamerat duke iu drejtuar gjyqtarëve të ndeshjes, me fjalët: "VAR-i është një m...".

Forlani: Ronaldo ishte egoist

Ish-futbollisti i Manchester Unitedit, Diego Forlan, thotë se Cristiano Ronaldo ishte egoist në zhveshtoren e Unitedit dhe se gjithmonë dëshironte ta kishte afër ndonjë pasqyre. 40-vjeçari, i cili kishte qenë pjesë e skuadrës nga "Old Trafford", thotë se portugezi nuk ishte njeriu i duhur për ta veshur fanellën me numër shtatë, të cilën më parë e kishte mbajtur David Beckham. "Ronaldo ishte një egoist në zhveshtore, jo si Beckhemi. Cristiano gjithmonë dëshironte të ishte afër ndonjë pasqyre. Ai e kalonte të gjithë ditën duke e shikuar veten në pasqyrë", ka thënë Forlani për "The Mirror".

Miocic rikthehet kampion bote

Stipe Miocic është rikthyer kampion i botës në peshën e rëndë në artet parciales mikse, pas fitores me "KO Teknik" në raundin e katërt ndaj Daniel Cormierit. Sfida ishte e vlefshme për ngjarjen UFC-241, zhvilluar sot në Kaliforni. Edhe pse Cormieri bëri një paraqitje më të mirë, sidomos në dy raundet e para, të cilat i fitoi, ai nuk arriti ta mbyllë ndeshjen. Madje edhe raundi i tretë ishte i ekuilibruar, ndoshta në favor të Cormierit, por që këtë herë i mungoi goditja finale. Në raundin e katërt Cormieri dukej i lodhur dhe disa grushte të forta radhazi në kokë dhe në trup të Miocicit përthyen ish-kampionin e botës. Një fitore e merituar e Stipe Miocicit nga Clevelandi, që rikthehet në majën e botës. Miocici u hakmor për humbjen e një viti më parë, kur u mund po me "KO teknik" nga Cormieri dhe tani mban sërish në gjoks gjerdanin e kampionit të botës. Miocici korri fitoren numër 19 në karrierën e tij, ku ka edhe tre humbje, ndërsa për Cormierin kjo është humbja numër 2, ndërkohë që ka edhe 22 fitore e 1 duel pa rezultat.



FTESË PËR OFERTË

Byroja Kosovare e Sigurimit fton të gjitha kompanitë e interesuara që të ofertojnë për tenderin me titull:

Qëllimi i kësaj kontrate është:

“FURNIZIMI ME MATERIAL SHPENZUES PËR NEVOJAT E BKS-së”

Ofertuesit janë të obliguar të dorëzojnë:

- Oferta financiare
- Certifikatën e biznesit me informatat mbi biznesin
- Certifikatën e TVSH-së
- Certifikatës e numrit fiskal
- Vërtetimin e lëshuar nga gjykata kompetente – vetëm për fituesin.
- Deklarata nën betim
- Vërtetim nga Administrata Tatimore se ofertuesi në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit për Ofertë]
- Dëshmi bankare për qarkullimin vjetor të parave.
- Referenca lidhur me furnizimin me material shpenzues.
- Deklaratën me shkrim nga ofertuesi lidhur me garancionin dhe cilësinë e furnizimeve.
- Cilësia e furnizimit të derivateve të jetë në harmoni me Udhëzimin Administrativ 07/2012- MTT

Të interesuarit duhet të dorëzojnë ofertën në zarf të mbyllur në zyrën e Byrosë Kosovare të Sigurimit në adresën Rr. Lidhja e Pejë, pn. (magjistratja Prishtinë-Fushë Kosovë) me datë 02.09.2019 nga ora 14:00-15:00.

Ofertat e dorëzuara pas kësaj kohe nuk merren parasysh.

Dosjen e tenderit mund ta kërkonit përmes email-it si në vijim: bks@bks-ks.com.



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosovo - Tax Administration of Kosovo



Njoftim për tatimpagues

Paguaj saktë tatimin!

Administrata Tatimore e Kosovës, rikujton të gjithë personat fizikë jo afarist, personat fizikë afarist dhe personat juridikë, se janë të detyruar të deklarojnë dhe të paguajnë tatimet dhe Kontributet Pensionale në mënyrë reale dhe në kohë, ashtu siç është përcaktuar me legjislacionin tatimor.

Aktivitetet e ATK-së, në vazhdimësi, do të përqendrohen pikërisht te personat, të cilët nuk i deklarojnë të ardhurat e krijuara dhe nuk paguajnë Tatimin dhe Kontributet Pensionale.

Për personat fizikë jo afarist, personat fizikë afarist dhe personat juridikë, të cilët nuk deklarojnë të ardhurat e krijuara dhe nuk paguajnë Tatimet dhe Kontributet Pensionale, ATK do të ndërmarrë masat ndëshkuese sipas legjislacionit tatimor.

Andaj, ATK, u bënë thirrje të gjithë personave që të deklarojnë të ardhurat e krijuara apo të korrigjojnë sa më parë deklaratat e tyre dhe të përmbushin të gjitha detyrimet tatimore të parapara me legjislacionin tatimor.

Me kryerjen e detyrimeve tatimore, kontribuoni direkt në financimin e programeve qeveritare siç janë: ofrimi i shërbimeve publike, arsimit me standarde të larta, mirëqenie shëndetësore dhe sociale, mbrojtje ligjore dhe siguri, si dhe infrastrukturë të përgjithshme për një mirëqenie më të mirë ekonomike dhe shoqërore.

ATK, në bashkëpunim me FMN, në implementim të Projektit “Përmbushja në Sektorin e Ndërtimtarisë”!

Administrata Tatimore e Kosovës



FTESË PËR OFERTË

Byroja Kosovare e Sigurimit fton të gjitha kompanitë e interesuara që të ofertojnë për tenderin me titull:

Qëllimi i kësaj kontrate është:

“FURNIZIMI ME DERIVATE TË NAFTËS DHE BENZINËS PËR NEVOJAT E BKS-së”

Ofertuesit janë të obliguar të dorëzojnë:

- Oferta financiare
- Certifikatën e biznesit me informatat mbi biznesin
- Certifikatën e TVSH-së
- Certifikatës e numrit fiskal
- Vërtetimin e lëshuar nga gjykata kompetente – vetëm për fituesin.
- Deklarata nën betim
- Vërtetim nga Administrata Tatimore se ofertuesi në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit për Ofertë]
- Dëshmi bankare për qarkullimin vjetor të parave.
- Referenca lidhur me furnizimin me derivate.
- Deklaratën me shkrim nga ofertuesi lidhur me garancionin dhe cilësinë e furnizimeve.
- Cilësia e furnizimit të derivateve të jetë në harmoni me Udhëzimin Administrativ 07/2012- MTT

Të interesuarit duhet të dorëzojnë ofertën në zarf të mbyllur në zyrën e Byrosë Kosovare të Sigurimit në adresën Rr. Lidhja e Pejë, pn. (magjistratja Prishtinë-Fushë Kosovë) me datë 02.09.2019 nga ora 14:00-15:00.

Ofertat e dorëzuara pas kësaj kohe nuk merren parasysh.

Dosjen e tenderit mund ta kërkonit përmes email-it si në vijim: bks@bks-ks.com.



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIC OF KOSOVO/REPUBLIKA KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/GOVERNMENT OF KOSOVA/ VLADA KOSOVA
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE- MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS-
MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORTA

DIVIZIONI I BURIMEVE NJERËZORE/DIVISION OF HUMAN RESOURCES/DIVIZIJA LJUDSKIH IZVORA

16.08.2019

NJOFTIM PER ANULIMIN E KONKURSIT

